



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

KUSH ËSHTË MEVDUDIU MUXHEDIDI I MADH I PERIUDHËS MODERNE

Merjem Xhemile

Botuar nga: Biblioteka Mehmet Akif Ersoj

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

Në vend të parathënies**Error! Bookmark not defined.**

PARATHËNIE

MEWLANA SEJJID EBUL ALA MEWDUDIUI ishte bartësi kryesor me vlerë i lëvizjeve për ringjalljen e Islamit në periudhën e kaluar të mëvonshme, andaj duhet të njihemi me jetën e tij që është me rëndësi të veçantë, me aktivitetet, qëllimet e idealet dhe synimet për përhapjen dhe ngadhënjimin në përgjithësi të idealit ISLAM. Në këtë punim i kam cituar gjerësisht veprat e shkruara dhe punimet e botuara me qëllim që ta informoj opinionin e gjerë me të dhëna të dorës së parë, të cilat kanë parë dritë gjatë aktivitetit të Mewlana Mewdudiut. Ata, të cilët janë më tepër të interesuar për të, kanë mundësi të studiojnë shumë vepra origjinale të tij në gjuhën urdu dhe në disa gjuhë të përkthyer.

Mewlana Mewdudiu nga natyra evitonte të fliste për veten dhe për aktivitetet private të tij, ndaj deri më sot, ai nuk ka asnjë biografi të shkruar. Vetëmohimi i tij i shprehur shumë shpesh tek ithtarët e tij shkaktonte frikë, ngase me këso sjellje ndaj kauzës së cilës ia kishte kushtuar jetën, i sillte dëm vetes. Ata bile insistonin prej tij që patjetër të shkruante vetë një biografi të veten. Mjerisht, këtë nuk arriti ta realizojë kurrë për arsye shëndetësore, andaj, ky punim i paraqitet lexuesit me shpresë se do të inspirojë ndonjë penë të talentuar muslimane që ta trajtojë këtë problem me një përkushtim më të madh, më të përkryer dhe me një dituri dhe shkrim të meri

Merjem Xhemile (ish- Margaret Markus)
Nju-Jork

MEWLANA SEJJID EBUL ALA MEWDUDI MUXHEDDID I MADH I PERIUdhËS MODERNE

Të gjitha lëvizjet e mëparshme për ringjalljen e Islamit janë çintegruar, kurse këto aktuale, pak a shumë, nuk kanë treguar sukses të mjaftueshëm, bile disa kanë dështuar gjatë kohës së realizimit të objektivave. Nga lëvizjet e shquara ndërkombëtare e cila edhe sot është aktive në botë, është edhe ajo e XHEMAT-E-ISLAMISË në Pakistan. Kjo lëvizje e dalluar deri më sot ekzistencën e saj dhe qëndresën e saj e ka siguruar falë një njeriu-Mawlana Sejjid Ebul Ala Mewdudiut.

Ky u lind më 25 shtator të vitit 1903 në Aurangabad, Hajdarabad të Dekanit në një familje e cila kishte rrjedhën nga Hvaxha Kutbuddin Mewdud-e-Çisti, themelues i rendit sufist Çisti, mësimet e të cilit zhvilloheshin në nënkontinentin Indo-Pakistanez, me anë të nxënësve të gjeneratës së tretë të Hvaxha Moinuddinit nga Axhmeri. Hvaxha Moinuddin ishte student i Hvaxha Uthman Harvanit, i cili ishte po ashtu student i Haxhi Sherif Zandanit, përndryshe trashëgues i Hvaxha Kutbuddin Mewdudiut. Babai i Mawlana Mewdudiut ishte avokat, por edhe Ser Sejjid Ahmed Hani ishte kushëri i nënës së tij, tek i cili ky u edukua më vonë në Aligarh dhe u rrit në një atmosferë duke qenë i pakënaqur me sundimin britanik dhe bartësit e regjimit të vendit. Kjo gjë, Mewdudiun e largonte nga civilizimi modern perëndimor, ashtu që babai i tij edhe vetë nuk dëshironte t'i dërgojë djemtë e vet në shkollat angleze, dhe për këtë arsye, ai i organizonte mësimet shkollore në shtëpi në gjuhën arabe, persishte dhe në gjuhën urdu. Kur ishte 16-vjeçar i vdiq babai dhe qysh prej atëherë filloi të punonte si gazetar. Më 1919 bëhet redaktor i “Uikli Taxhit” (Weekly Taj), gazetë që dilte në Xhabalpur, dhe kështu vazhdoi deri në vitin 1920 kur gazeta u bë e përditshme. Në vitin 1922 bëhet botues i gazetës dyjavore në Delhi, që quhej

“Muslimani i Vogël”. Prej vitit 1924 deri në fund të vitit 1928 bëhet botues i gazetës “Al-Xhemiati” në Delhi, e cila ishte organ i Xhemiati-ul-Ulema-e-Hind, por disa muaj më vonë u sëmur dhe u kthye në Delhi. Në vitin 1931 përsëri kthehet në Hajdarabad dhe më 1932 filloi ta publikojë revistën mujore, me të cilën përherë lidhet emri i tij - “Terxhuman ul Kur’an”.

Në mars të vitit 1938, me thirrjen e Ulemasë Muhammed Ikbali shkoi në Penxhab për ta ringjallë Ligjin islamik, dhe me këtë rast u vendos në qarkun Gurdaspur, ku kishte në dispozicion 80 akra tokë, një xhami dhe katër apo pesë ndërtesa, të cilat më vonë u bënë Akademia “Dar ul Islam”. Ulemaja Ikbali vdes në prill, kurse Mawlana Mewdudiu shkoi për në Lahore ku emërohet si dekan pa rrogë i Fakultetit Teologjik. Pas një viti organet administrative kërkojnë për ta paguar, por ai refuzoi t’i pranojë rastroksionet në rrafshin e programit të mendimeve të tij, ndaj e lëshoi këtë universitet, por mbeti në Lahore tre vjet e gjysmë gjatë të cilave në gusht të vitit 1941 themeloi organizatën “Xhema’at-e-Islami”. Në qershor të vitit 1942 lëshoi Lahoren dhe u kthye në “Dar ul Islam” ku vazhdoi të shkruajë dhe të predikojë.

Prej kohës kur themeloi “Xhema’at-e-Islamin”, jeta e tij ishte e lidhur pa masë për fatin e lëvizjes së vet.

Kështu, Mawlana Mewdudiu ishte një autodidakt. Qysh si djalosh 17 vjeçar, kur e përkrahte lëvizjen për Hilafet, u dha pas zhvillimit të mendimit kritik, gjë që i mundësoi që verbërisht mos ta përkrahë atë lëvizje. “Kjo është pjesë e natyrës sime, unë kurrë nuk i marr sendet si të përfunduara, por më parë mendoj mirë për çdo problem i cili më shtrohet ose i cili tek unë zgjon ndonjë interes, dhe pastaj mundohem për ta kuptuar thellësisht. Lidhur me këtë, fillova të bindem për gjendjen faktike të Hilafetit dhe të situatës në Turqi, dhe, si përfundim, zbulova atë se

udhëheqja e atëhershme e Turqisë, pas Luftës së Parë Botërore, ishte inspiruar me ndjenja nacionaliste turke, duke qenë e frymëzuar me ideale sekulariste të xhon-turqve, të cilët ishin shkolluar në Perëndim. Në të njëjtën kohë zbulova faktin se si armiq të Islamit e kanë nxitur nacionalizmin dhe aspiratat nacionaliste tek arabët, në mënyrë që në vend që të jenë së bashku gjatë Luftës së Parë Botërore, turqit dhe arabët në mes veti u bënë armiq. Për mua kjo gjë ishte e qartë, për arsye se kjo gjendje paraqiste një kundërthënie të vërtetë për situatën në Turqi. Në një rën anë, pushtetmbajtësit aktualë u bënë trashëgimtarë të Hilafetit, e në anën tjetër, Halifeja duke rënë nën sundimin britanik dhe duke mos qenë në gjendje që as formalisht të ketë kompetenca, prapëseprapë dëshironte t'i prijë vendit rrugës që shpie drejt në sekularizëm. Jo vetëm kjo, por nacionalizmi turk, duke paraqitur mbështetje për ekzistencën e tyre, dhe shkak për të gabuar edhe më shumë, ngase me këtë vetë u larguan nga lojaliteti ndaj arabëve, të cilët ende mbetën nën Turqinë, ndaj kurdëve dhe popullatës tjetër joturke. Por këto nuk ishin gabimet e vetme të pushtetit turk. Ata vazhduan ende t'u prijnë arabëve në këtë mënyrë, duke i injoruar makinacionet e fëlliqta krishtere dhe çifute, përvetësuan nacionalizmin arab si mënyrë të llogaritur kundër nacionalizmit turk, kaluan në anën e anglezëve dhe përfundimisht u pajtuan me fatin se kurrë më nuk do t'i sundojnë vendet islame, ndryshe, ku gjendeshin vendet e shenjta. Në kohën kur isha duke i realizuar këto qëndrime të mia, fillova të besoj se Hilafeti, për të cilin muslimanët e Indisë ishin të gatshëm të sakrifikojnë çdo gjë, në të vërtetë më nuk ekzistonte. I gjithë trupi politik i Komunitetit islam në Indi ishte zotuar për ta mbrojtur Hilafetin, i cili ishte jashtë kontrollit të tyre. Pyesja veten përse lëvizja jonë ka një fat të tillë kur dihej se Hilafetin e kanë sjellur në greminë liderët e sekularistëve turq?

Në vitin 1924 ngjarjet e vërtetuan frikën time dhe më mësuan se si të veproj në mënyrë korrekte. Atë ç'pata kujtuar ajo edhe ndodhi, dhe me këtë u dërrmua besimi im në udhëheqjen kombëtare turke. Në atë vit, udhëheqësit e Turqisë shpallën suprimimin e Hilafetit për të cilin muslimanët e Indisë patën qëndruar si një trup i tërë për ta mbrojtur. Ne jemi ngritur në mbrojtje në emër të Hilafetit duke lënë pas dore çdo problem që gjendej para nesh në vendin tonë, dhe kështu, ky popull i tërë mbeti duke shikuar se si manteli i Hilafetit gjuhet anash si i panevojshëm”.

Po në atë vit, Bashkimi Indu-Musliman, të cilin e udhëhiqte Kongresi, përkrahu lëvizjen për Hilafetin, por edhe muslimanët përkrahën lëvizjen induse Svaraxh (Swaraj), e cila përfundoi në mënyrë tragjike. Shumë kryengritje lokale atëherë u thyen në tërë viset e Indisë, dhe të gjithë udhëheqësit indusë, duke llogaritur këtu edhe Ghandin, e dënuan bashkësinë muslimane të vendit, megjithëqë për këto kryengritje edhe muslimanët u ndëshkuan, bile më shumë, ngaee i përkrahën indusët dhe ndaj të cilëve treguan simpati të madhe, edhe pse vetë indusët në këto raste ishin agresivë. Në fund të vitit 1924, këto ngjarje nuk na bënë të dyshojmë në pikëpamjet tona sepse ishte e qartë se Bashkimi Indu-Musliman, në të vërtetë, nuk do të përtërihet”.

Për herë të parë, Mewlana Mewdudiu zgjoi interesim në opinion në vitin 1926 me veprën e botuar “AL-XHIHAD FIL AL-ISLAM”, në të cilën bënte krahasime të detajizuara në kuadër të konceptit islam mbi xhihadin, me anë të së drejtës moderne ndërkombëtare për gjendje lufte, duke e dalluar me kujdes XHIHADIN nga koncepti i vjetër dhe ai i ri i luftës. Mewlana Mewdudiu më 1932 përpiloi librin e tij më të popullarizuar dhe të njohur me titull “Të kuptuarit e drejtë të islamit”, duke tentuar që me këtë të përfitohet rinia moderne për ta kuptuar besimin e çiltër dhe të drejtë. “Qëllimi për ta kuptuar Islamit” është përkthyer në më se 12 gjuhë të huaja, duke vazhduar së botuari gjithnjë e më shumë dhe duke u shitur me mijëra kopje në tërë botën.

Ky libër po ashtu, më vonë bëhet tekst standard shkollor në disa vende islamike. Gjatë vitit të përmendur, Mawlana Mewdudiu filloi me publikime të revistave mujore, të cilat gjithnjë kanë qenë të titulluara me emrin “TERXHUMAN UL-KUR’AN”, të cilat gjatë disa dekadave shpjegonin për çiltërinë e Islamit, dedikuar edhe publikut të shkolluar urdufolës.

“Kur fillova ta publikoj “Terxhuman ul-Kur’anin” më 1932 në Hajdarabad, në mendjen time plani i aksionit ishte që unë së pari ta lë pas dore përkrahjen e kulturës perëndimore dhe idetë e saj, të cilat mbisundonin inteligjencien muslimane, në mënyrë që me fakte t’i bind se Islami i ka vetë ligjet e veta të jetës, kulturën e vet, sistemin e vet politik dhe ekonomik, filozofinë dhe sistemin e edukimit, me të cilat tregon epërsi të madhe ndaj atyre të gjithave të cilat Perëndimi mund t’i ofrojë. Kam kërkuar që t’u tregoj për njohuri të gabuara, të cilat ata i huazonin nga të huajt, përkitazi sidomos me kulturën dhe civilizimin”.¹

Gjatë këtyre viteve, kur lëvizja në Pakistan në krye me Ligën Muslimane pat grumbulluar forca, po ashtu edhe Mawlana Mewdudiu në tërësi pranon dhe përkrah konceptin e dy popujve, dhe që muslimanët e nënkontinentit duhet të jenë të lirë të zhvillohen dhe të përparojnë në kuadër të një shteti të ndarë të tyre, por në të njëjtën kohë, ai me ashpërsi kundërshtonte vetadministrimin lokal me të cilin vetëm ashpërshej urrejtja dhe frika midis muslimanëve dhe indusëve. Insistonte në atë që muslimanët nuk ishin vetëm një popull i thjeshtë, por popull i ngarkuar me mision për ta përhapur porosinë islame në tërë botën. Muslimani nuk ishte musliman i denjë vetëm me prejardhje muslimane me të cilën ka lindur nga familja muslimane dhe të cilit i është dhënë emri

¹ “Twenty-nine Years of Jama’at-e- Islami (29 vjet të Xhema’at-e-Islamit) Seyyid Abul Ala Mewdudi, The Criterion, Karachi, November-December 1970, p.p.32-35, abridged. (Shkurtim).

musliman, por vetëm ai i cili në jetën praktike dëshmon përkatësinë e vet në mënyrë të qartë ndaj fqijut jomusliman, me aprovimin e Kelime-i-Shehadetit. Vetëm me profesion nuk mjafton dikush të bëhet musliman. Për t'u bërë musliman i denjë, së pari, me emrin që e mbanë, duhet që të jetojë në frymën islame në pajtim me urdhrat e Kur'anit dhe Sunnetit, dhe me këtë të ketë respekt tek fqiu indus dhe ta sendërtojë Tebligun dhe rolin e fuqishëm të misionarit.

“Pa dyshim, Liga Muslimane, përnga numri i ithtarëve rritej shumë shpejt, por me këtë kuptova se derisa disa vetë ishin anëtarësuar, mundësohej me këtë edhe zhvillimi i një lëvizjeje e cila shpiente nga themelimi i një shteti nacionalist musliman, dhe kuptova faktin e sigurt se ata nuk ishin të përcaktuar për një shtet islam. Struktura e liderëve dhe e atyre që anëtarësoheshin si të tillë në Ligën Muslimane, në të vërtetë, ishin në ballë të atyre të cilët nuk kanë qenë të frymëzuar me aso ndjenja dhe atë drejtim, ngase jeta e tyre moderne, arsimimi dhe mënyra e të menduarit, nuk premtonin se do të jenë në gjendje ose të kenë mundësi për të themeluar një shtet të vërtetë islam. Ata ishin vetëm të aftë të themelojnë një shtet nacionalist për muslimanët, të cilin më vonë nuk do të ishin në gjendje ta kthejnë në një shtet islam”.²

Këto ishin tema kryesore nga seriali i artikujve të shkruar gjatë periudhës 1939-1940, të titulluar me “MUSLIMAN EUR MEWXHUDA SIYASI KASHMAKASH”. Këtu, por edhe më parë se të ndahej nënkontinenti, ai predikonte se nëse Pakistani nuk do të bëhet një shtet i vërtetë islam, dhe nëse një politikë hipokrite e udhëheqjes do të vazhdojë si veti e tyre, e ndarë nga ideologjia kohezive e Islamit, atëherë nacionalizmi lokal, i bazuar në rajonalizëm, shumë shpejt do ta afirmojë vetveten, dhe me këtë, çintegrimi eventual i vendit do të bëhet i pashmangshëm.

² Ibid, p. 49.

“Për mua këtu shtroheshin tri probleme: Çka duhet bërë që t’i shpëtojmë muslimanët nëse shteti nuk ndahet? Çka duhet bërë për muslimanët që do të mbeteshin në Indi në qoftë se ndahet shteti? Në rastin e fundit, çka duhet bërë për ta evituar shtetin e ri islam që mos të bëhet një shtet efektiv joislam?, dhe për këto t’i trasojmë rrugët për një kohë të gjatë që ky shtet në vend të shtetit joislam, të bëhet një shtet i vërtetë islam. Ndodhi edhe kjo, se pas këtyre mendimeve mbi tri tezat e përmendura, lindi tek unë një ide e cila do t’i përgjigjej situatës për themelimin e një organizate me emrin “XHEMA’AT-e-ISLAMI”. Mendimet që i mbroja nuk i ishin drejtuar shumicës së popullit, për të cilën gjë qesh qortuar prej disave, kështu që organizata përfaqësonte një grup të vogël njerëzish të cilët pajtoheshin me mua, dhe të cilët, eventualisht, ekzistonin si pjesë e Xhema’atit. Gjithnjë më mbushej mendja se këtë Xhema’at duhet ta përbëjnë njerëz të cilët nuk do të ishin vetëm besimtarë të Islamit, por ata që kishin një karakter konform me besimin në të, kështu që fuqinë e vërtetë nuk e paraqet numri i njerëzve, por cilësia, dhe kështu, në Xhema’at do të regjistroheshin ata njerëz të cilët duhet t’i kenë cilësitë e larta morale, pa marrë parasysh sa i vogël do të ishte numri i tyre, i cili do të ishte në gjendje që me fjalë dhe punë ta përfitojë masën muslimane, të jetë i besueshëm dhe i sigurt, të ketë vetëbesim të vërtetë ndaj qëndrimit të vet dhe i sigurt se do të jetë në gjendje që këto t’ia përkushtojë kauzës për të cilën është përcaktuar. Gjithashtu, pata vendosur që Xhema’ati të bëhet një organizatë mirë e thurur, shumë e disiplinuar dhe pa standarde të luhatshme. Një ide tjetër që lindi në mendjen time gjatë kohës së organizimit të Xhema’atit, ishte fakti se kjo organizatë do të përbëhet nga dy kategori njerëzish: nga grupi i atyre të arsimuar brenda sistemit të vjetër, dhe nga ata të arsimuar brenda sistemit të ri, në mënyrë që ata të bashkëpunojnë në harmoni për ta ndërtuar rendin islamik. Xhema’ati, po ashtu, do të përfiqej t’i afrojë mendimet e të gjitha sekteve dhe të drejtave të

mendimit. Gjithashtu, edhe joshitët do të ishin anëtarë të plotfuqishëm të Xhema'atit, bashkë me një shumicë e cila na u bashkua si simpatizues (muttefikin)”.³

Askush me entuziazëm më të madh nuk e përkrahu lëvizjen për Pakistan në Indinë muslimane se Mawlana Mewdudiu. Në të gjitha shkrimet dhe fjalimet e tij, ishte në gjendje t'i bindë muslimanët e Indisë se ata përfaqësonin një bashkësi të dalluar, dhe si të tillë, ata duhet të vetadministrohen në shtetin e vet, me kusht nëse janë në gjendje ta asgjësojnë kërcënimin nga dominimi dhe persekutimet që u bëheshin nga ana e indusëve. Në të njëjtën kohë, disa luftëtarë të singertë për liri si Mawlana Muhammed Ali Xhevher, Mawlana Shewkat Ali, bile edhe Kaid-e-Azam, të cilët në të njëjtën kohë ishin edhe anëtarë të Kongresit Kombëtar të Indisë, kurse Mawlana Mewdudiu në këtë asnjëherë nuk i shoqëroi. Kur Kaid-e-Azami iu bë thirrja që t'i bashkohet Xhema'at-e-Islamit, ai këtë e pat refuzuar duke u arsyetuar se mos krijohet ndonjë gjendje konflikti ndërmjet Xhema'atit dhe Ligës Muslimane; njeriu këtu aktivizohej për çështje të një ideali më të lartë, kurse tjetri duhej të bënte një presion të pashmangshëm në masën e muslimanëve të Indisë me qëllim që të arrihet bashkimi i kombit, por nëse do të humbin, atëherë misioni i Xhema'atit plotësisht do të bëhej i pamundur.⁴

Pas ndarjes së nënkontinentit më 14 gusht 1947, Mawlana Mewdudiu ia kushtoi të gjitha forcat e veta themelimit të një rruge të pastër islamike në Pakistan. Prej janarit deri në mars të vitit 1948, ai dorëzoi në shtyp një seri prej pesë fjalimeve për t'i transmetuar në radio, në të cilat

³ Ibid, p.p. 49-55, abridged (shkurtim).

⁴ Quoted from Kamaruddin Han's statement in the Thinker weekly, Karachi, December 27, 1963. (Përmendur nga Kameruddin Hani në deklaratë në Thinker weekly...).

ekspozoheshin vetitë kryesore shpirtërore, morale, politike dhe ekonomike të mësimëve islamike.⁵ Islami për të nuk ishte vetëm një sllogan. Ishte i vetmi në mes liderëve të vendit tek i cili pajtohej çdo fjalë me veprimin e tij. Me një energji të hatashme përkrahte shtetin sovran islam, duke mbajtur fjalime dhe duke mobilizuar përkrahje për themelimin e një shteti kuptimplotë islamik. Dhe, për arsye se qëllimet e tij të sinqerta nuk toleroheshin dhe nuk pajtoheshin me interesat perëndimore, u akuzua edhe si armik i shtetit me rastin e kërkesave për hartimin e një Kushtetute të vërtetë islamike, dhe për këtë qëndroi në burg prej 4 tetor 1948 deri më 25 maj 1950. Megjithatë, përpjekjet e tij për t'i arritur qëllimet për hartimin e bazës për një Kushtetutë islamike të vendit, patën sukses me vetë faktin se më 7 mars 1949, Asambleja Kombëtare Kushtetuese i pranoi “Objektivat e Rezolutës”, në të cilat ishin të pranishme kërkesat e tij.

Teksti në “Objektivat e Rezolutës” ishte ky, si vijon:

Pasi që sovraniteti mbi Gjithësinë i takon vetëm All-llahut Fuqiplot, edhe pushtetin të cilin Ai ia dhuroi shtetit të Pakistanit përmes popullit të vet me qëllim sprovimi, por me të gjitha kufizimet e përcaktuara nga ana e Tij, kjo do të thotë se ky është një besim i shenjtë;

Kjo Asamble Kushtetuese, duke përfaqësuar popullin e Pakistanit, ka përcaktuar kornizat e Kushtetutës për shtetin sovran dhe të pavarur të Pakistanit;

Në të cilin pushteti do ta ushtrojë administrimin e tij dhe autoritetin përmes përfaqësueve të zgjedhur nga ana e popullit;

⁵ The Islamic Way of Life (Mënyra e jetës në Islam), S.A.A. Mewdudi, Islamik Publication, Lahore, December, 1965

Në të cilin parimet e demokracisë, pavarësisë, barazisë, tolerancës dhe drejtësisë shoqërore, si të pranuar në Islam, plotësisht do të përcillen;

Në të cilin muslimanët do të jenë të aftë ta rregullojnë jetën e tyre, në sferën individuale dhe kolektive, në pajtim me mësimet dhe kërkesat e Islamit, në mënyrë si janë parashtruar në Kur'an dhe Sunnet;

Në të cilin kujdesi adekuat do të sigurohet edhe për minoritetet, të lira në zbatimin në praktikë të besimeve të tyre dhe në zhvillimin e kulturës së tyre;

Meqë nga territoret të cilat aktualisht e përbëjnë ose ato të cilat i shoqërohen Pakistanit, por edhe nga territoret tjera të cilat në të ardhmen do t'i bashkoheshin Pakistanit, duhet të formohet një federatë ku njësitë administrative do të përbënin autonomitë me disa përkufizime të pushtetit dhe administratës, të cilat do të mund të përcaktohen;

Në të cilin do të garantohen të drejtat fundamentale për çdo njeri, duke llogaritur statusin dhe oportunitetin ndaj ligjit, së drejtës sociale, ekonomike dhe politike, lirinë e mendimit, të shprehjes, të fesë dhe besimit, të mënyrës së lutjeve, dhe për subjekte të shoqatave që veprojnë në kuadër të kërkesave për të drejtat ligjore dhe moralin shoqëror;

Në të cilin do të sigurohet pavarësia e plotë e gjyqit;

Në të cilin integriteti i territoreve të federatës, i pavarësisë së tyre, i të gjitha të drejtave të tyre, duke llogaritur sovranitetin e plotë në tokat e tyre, të detit dhe të ajrit, duhet të mbrohet;

Në këtë mënyrë Pakistani do të mund të prosperojë dhe të jetë një vend me drejtësi të plotë dhe me nder midis kombeve të botës, i cili do të mund t'i japë kontributin e vet të plotë paqes ndërkombëtare, përparimit dhe fatit njerëzor.⁶

Gjatë shekujve, për herë të parë, 31 ulema duke përfaqësuar të gjitha drejtimet më të shquara të mendimeve në Pakistan, si: Deobandi, Brelvi, Ehli Hadith dhe Shiitët, të prirë nga Mawlana Mawdudiu, mbajtën konferencë në Karaçi prej 21-24 janar 1951, ku formuluan pajtimin e plotë në 22 pika kryesore, që i takojnë një shteti modern islam, të cilat do të bëhen pjesë përbërëse të Kushtetutës së re. Vendimi unanim i këtyre ulemave ka përcaktuar këto kushte:

Kushtetuta e shtetit islam duhet t'i përcaktojë këto parime themelore, si:

1. Sovraniteti themelor mbi gjithë Natyrën dhe Ligjet i takon All-llahut, Rabbi-ul-Alemin.
2. Ligji në tokë do të mbështetet në Kur'an dhe Sunnet dhe asnjë ligj ose urdhër administrativ që është në kundërshtim me Kur'anin dhe Sunnetin nuk do të pranohet.

Interpretimi i shënimeve: Nëse një ligj është në fuqi në vend, i cili është në kundërshtim me Kur'anin dhe Sunnetin, patjetër duhet të anulohet në Kushtetutë dhe gradualisht këto ligje, brenda një periudhe të caktuar, të përmirësohen dhe të figurojnë në frymën e Ligjit Islam, ose plotësisht të anulohen.

⁶ Religion and Politics in Pakistan (Feja dhe politika në Pakistan) Leonard Binder, University of California, Press Berkley, 1966, p.p. 142-143.

3. Shteti nuk do të bazohet në parimet dhe konceptin gjeografik, gjuhësor, ose në ndonjë koncept materialist, por vetëm në ato që i takojnë skemës islame të jetës.
4. Shteti duhet të marrë mbi vete përkrahjen e asaj që është e Drejtë () dhe ta mposhtë atë që është Gabim () sipas postulateve të Kur'anit dhe Sunnetit, t'i ndër marrë të gjitha masat për ta gjallëruar dhe lartësuar doktrinën islame dhe t'i krijojë kushtet për arsimimin dhe edukimin islam në frymën e kërkesave dhe mendimeve të shkollave të ndryshme të njohura.
5. Shteti duhet të ketë për detyrë t'i forcojë lidhjet për bashkimin dhe vëllazërimin me gjithë muslimanët e botës, në mesin e muslimanëve në shtet t'i pengojë të gjitha tendencat e paraqitjeve të besëtytnive në Islam, të cilat kanë të bëjnë me ndarjen e njerëzve në baza racore, gjuhësore, territoriale, ose të karakterit materialist, po ashtu edhe ta ruajë dhe ta forcojë unitetin brenda MILLET-i-ISLAMIJES.
6. Pushteti duhet të jetë përgjegjës për garantimin dhe sigurimin e nevojave humane, si p.sh. ushqimin, veshjen, banimin, mbrojtjen shëndetësore, arsimimin për të gjithë banorët pa marrë parasysh përkatësinë fetare, racore, ta sigurojë ekzistencën për ata të cilët nuk kanë mundësi të përkohshme ose të përhershme ta sigurojnë ekzistencën për shkak të papunësisë, sëmundjeve, ose për shkaqe të tjera.
7. Qytetarët do të kenë autorizime për t'u thirrur në të drejtat e tyre që u takojnë në bazë të Ligjit Islam, p.sh. ata do të sigurohen në suaza të ligjit, duhet të kenë sigurim të plotë për jetën, pronën dhe nderin e tyre, lirinë fetare dhe të besimit, lirinë për mënyrën e lutjeve, lirinë personale, lirinë e shprehjes, lirinë e qarkullimit, lirinë e shoqërimit, lirinë për punë, barazi në rastet e të drejtës së fitimit nga shërbimet publike.

8. Asnjë qytetar nuk do të privohet nga të drejtat e përmendura, pos atyre që janë kundërligjore, dhe nuk do të dënohet ose të ngarkohet pa pasë të drejta të plota në raste të mbrojtjes dhe pa vendim të gjyqit ligjor.

9. Shkollat e mendimeve islame do të njihen brenda kufijve ligjorë dhe duhet të ketë liri të plotë fetare, të drejtë për mësim fetar për besimtarët, dhe liri për propagandimin e pikëpamjeve të tyre. Lënda e cila i takon statusit personal të njeriut, do të ekzekutohet në frymën e kodeve gjegjëse të jurisprudencës (). Do të ishte e dëshiruar që trajtimi i këtyre lëndëve të ekzekutohet nga ana e kadive (Qazts).⁷

10. Qytetarët joislamë të shtetit, brenda kufijve ligjorë gëzojnë liri të plotë fetare dhe të besimit, për mënyrën e jetës, për kulturën dhe edukimin fetar. Ata duhet të kenë autorizime për trajtimin e statusit të tyre personal sipas ligjeve të tyre fetare, dokeve dhe zakoneve të tyre.

11. Të gjitha obligimet e shtruara nga ana e shtetit, me kufizime të Sheriatit për qytetarët joislamë, patjetër do të respektohen. Kjo njëherit ka të bëjë edhe me qytetarët muslimanë kur është fjala për të drejtat qytetare, ashtu siç është cekur në paragrafin 7.

12. Kryetari i shtetit duhet të jetë mashkull musliman, besimtar i denjë, i aftë dhe i drejtë në të gjykuar ndaj popullit, dhe të ketë besim ndaj përfaqësuesve të tij të zgjedhur.

13. Përgjegjësia për administrimin e shtetit më parë do t'i bie vetë kryetarit të shtetit, por ky mund të autorizojë ndonjë person ose trup për të kryer disa punë të pushtetit.

⁷ A qazi (or qadi) is a judge in a Muslim court of law. (Kadiu është gjyqtar i gjyqit musliman ligjor).

14. Qeverisja nga ana e kryetarit të shtetit nuk mund të jetë autokratike por konsultative (); ai duhet të shkarkohet nga situatat e dyshimta me ndihmën e konsultimeve me persona të pozitave gjegjëse në qeveri dhe me përfaqësuesit e zgjedhur nga ana e popullit.
15. Kryetari i shtetit nuk duhet të ketë të drejtë ta suspendojë Kushtetutën në tërësi ose pjesërisht apo ta vendosë administrimin me çdo kusht, por kjo të bëhet vetëm në bazë të konsultimeve.
16. Trupi i ngarkuar për ta zgjedhur kryetarin e shtetit, gjithashtu ka të drejtë ta revokojë këtë me shumicë votash.
17. Duke i respektuar të drejtat civile, kryetari i shtetit nuk qëndron mbi ligj.
18. Të gjithë qytetarët edhe anëtarët e pushtetit, zyrtarët ose personat privatë, do të jenë subjekte të ligjit të njëjtë, i cili do të zbatohet për të gjithë njëloj nga ana e gjyqit të njëjtë ligjor.
19. Gjyqësia (judikatura) do të jetë e ndarë, e pavarur në ekzekutimin e vendimeve të veta.
20. Propagimi dhe publikimi i pikëpamjeve pluraliste ideologjike, të drejtuara në rrënimin e parimeve themelore dhe fundamentale të shtetit islam, do të ndalohen.
21. Zonat e ndryshme ose rajonet në vend do të konsiderohen si njësi administrative të vetë shtetit. Këto nuk do të jenë njësi hapsinore të bazuara në racë, gjuhë ose fise, por vetëm rajone administrative të cilave mund t'u ofrohen disa kompetenca të pushtetit lokal të mbikëqyrura nga pushteti qendror, aq sa është e nevojshme për përshtatjen administrative. Këto njësi nuk kanë të drejtë të ndahen nga shteti.

22. Kushtetuta e cila është në kundërshtim me dispozitat e Kur'anit dhe Sunnetit, nuk mund të jetë lëndë për shqyrtim. Vetëm ajo që është në pajtueshmëri me Kur'anin dhe Sunnetin do të jetë e plotfuqishme.

Gjatë viteve 1952-1953, kur shumica dërrmuese e popullit pakistanez në Penxhab kërkoi që Kadianitë, si sekt, në Kushtetutë të konsiderohen si grup minoritar (pakicë) i ndarë, Gjyqi ushtarak këtë propozim e refuzoi, kurse Mewlana Mewdudiu për këtë rast pat shkruar një artikull me titull “Problemi Kadian”, me qëllim që ta përkrahë atë kërkesë, duke e gjykuar politikën e pushtetit.

Çështja e Kadianive është krejtësisht diçka tjetër nga akuzat e ndërsjella të herezisë midis sekteve të ndryshme. Kadianitë kishin themeluar një profeci të re në krye me Mirza Ghulam Ahmedin (1839-1908), me të cilën të gjithë ata që nuk e pranuan këtë qëndrim i dënuan si qafirë. Kadianitë depërtuan në shoqërinë islame duke u paraqitur si muslimanë, përhapën një propagandë agresive me qëllim të prozelitizmit (konvertim me mjete të pandershme të njerëzve prej një feje në bindjen e tyre), duke e shtuar gjithnjë numrin e bashkëmendimtarëve në dëm të shoqërisë islame. Në këto kushte, kërkesa për ndarjen e Kadianive nga Ummeti Islam u përkrah edhe më parë nga shumica e muslimanëve, për arsye se një pjesë e madhe e tyre kanë vuajtur nga Kadianitë. Kadianitë, në njërën anë, i gëzonin të gjitha privilegjet si minoritet, të cilët praktikisht kanë arritur të bëjnë një ndarje të dëshiruar në pjesën e besimtarëve muslimanë, kurse, në anën tjetër, i kanë rrëmbyer në mënyrë të hatashme të gjitha beneficionet nga pjesa dërrmuese që përbënte petkun islam, kështu që, numri i tyre rritej nga zhvillimi i një propagande subtile duke i bindur injorantët për ta pranuar besimin e tyre, në ndërkohë edhe duke e grabitur pa skrupull pjesën më të madhe të privilegjeve

se sa u takonin përngja numri, në fushat e ndryshme të një jete kolektive. Ky ishte shkaku përse shumica me këmbëngulje kërkonin ndarjen e tyre nga shoqëria islame, e jo si pakicë muslimane.⁸

Andaj, më 28 mars 1953, Mawlana Mewdudiu u gjend në arrest dhe u burgos pa gjyq. Kur Gjyqi ushtarak e dënoi me vdekje, me varje, ai e pat deklaruar këtë: “Nëse kjo është dëshirë e All-llahut, me dëshirë e pranoj këtë fat, por nëse nuk është dëshira e Tij që unë të vdes tani, nuk ka rëndësi se çka duan të bëjnë me mua, ata nuk mund të më frikësojnë në asnjë mënyrë”.

Është interesant të ceket edhe kjo se së shpejti pas fjalëve të fundit të dënimit me vdekje, anëtari i CID-it (Komiteti për Hulumtime të Kriminalitetit), Mian Enver Ali, i veshur me rroba civile, i përcjellur nga gardiani, kërkoi që mbi të të bëhet një observim i gjendjes lidhur me reaksionin e shkaktuar tek Mawlana Mewdudiu pas shpalljes së dënimit me vdekje. Në rastet e tilla shkaktohet një ndryshim i shpejtë dhe gjendje abnormale mentale, të cilat zakonisht përcillen nga ana e një polici zyrtar dhe gati shumica e të dënuarve me vdekje tregojnë gjendje shumë shqetësuese, kurse Mawlana Mewdudiu ishte krejtësisht në gjendje normale, sikurse mos t'i kishte ngjarë asgjë jonormale. Pastaj, atë e kishin vendosur në një birucë të vogël dhe të ngushtë të burgut për të dënuarit me vdekje, i veshur me pixhama pa uçkur dhe pa këmishë, i ulur në një shtrat me kashtë, kurse pranë tij, kishte një shtambë me ujë prej dheu. Kur gardiani ia ofroi Mewdudiu letrën për ta shkruar lutjen për ta falur nga dënimi me vdekje, Mewdudiu bërtiti dhe tregoi qartë “Jo”. Ai bile nuk përgjigjej në shumë pyetje që i bëheshin, gjë që është e zakonshme kur dikush kërkon për ta vizituar dikë në burg ose kur kërkon që ta shërbejnë me çaj ose kafe. Mian Enver Ali ka treguar për këtë ngjarje, e cila si e tillë, në përvojën e tij, kurrë nuk mundi të harrohet.

⁸ The Qadiani Problem, Abul Ala Mewdudi, Jama'at-e-Islami, Karachi, 1953, p.p. 22,23.

Protestat në botën islame kundër këtij vendimi për vdekje u bënë aq të mëdha sa që pushteti që i detyruar ta zëvendësojë dënimin me vdekje me burgim me kohëzgjatje prej 14 vjetësh.

Derisa Mawlana Mewdudiu ishte duke e vuajtur dënimin kryetari i gjyqit, Muhammed Munir në bashkëpunim me gjyqtarin M.R. Kajani, përpiluan raportin e tyre famoz, të njohur si “Raporti i Munirit”, në të cilin është parashtruar hulumtimi që ka të bëjë me agjitetin popullarizues kundër sektit Kadiani, dhe në bazë të kërkesave publike për largimin e Çaudri Zafrullah Hanit dhe kadianive të tjerë nga postet e tyre, u vlerësua se këto kanë qenë shkaqet kryesore të trazirave që janë bërë dhe i fanatizmit musliman. Nisur nga kjo, ata kishin përfunduar mendimin se në rast se Pakistanit do t’i lejohej të bëhet një shtet islam, të gjithë banorët jomuslimanë do të bëhen objekt i persekutimeve dhe sektet e ndryshme muslimane vazhdimisht do të kacafyteshin në mes veti, kështu që, ligjet e tilla të vjetruara do t’i përforconin konfliktet me standardet e “botës së civilizuar” dhe me Pakistanin në tërësi, për shkak të prapambeturisë kulturore dhe pushtetit reaksionar, dhe në këtë kuptim, ky shtet do të mbetej jashtë komunitetit ndërkombëtar. As orientalistët perëndimorë e as misionarët e krishterë nuk e kanë sulmuar aq ashpër Islamit sa që këtë e bëri “Raporti i Munirit”. Tragjedia ishte më e madhe sepse vetë autori ishte musliman, kështu që efektet shumëfishoheshin me të madhe. Mawlana Mewdudiu dhe Xhema’ti-e-Islami, të vetëdijshëm për këto efekte, përgjigjeshin në këto sfida me fakte se këto janë të pavërteta dhe përgjigjeshin në shpifjet që i bëheshin personalisht Mewdudiu dhe konceptit të vërtetë të një shteti islam në Pakistan. Ndaj konkluzave të shtruar të Munirit, për një riinterpretim thelbësor të Islamit, i cili do të përputhej me mendimet bashkëkohore, dhe në këtë mënyrë që Pakistani të krijojë një imazh të përshtatshëm në opinionin botëror, Mawlana Mewdudiu kështu i përgjigjet:

“Në qoftë se dikush dëshiron ta riorientojë dhe ta rikonstruktojë Islamin, le ta bëjë atë. Ndryshe, përpjekjet e tij janë të dëshirueshme, nëse është në gjendje të argumentojë në bazë të provave të shëndosha se cilat pjesë të Islamit janë të vjetruara, përse nuk janë aktuale dhe me çka mund të zëvendësohen, pra, cilat pjesë të tij janë vitale dhe aktuale dhe në ç’mënyrë ai mendon këto t’i gjallërojë? Por, duhet të kuptojë thellësisht dy gjëra. E para, ne mund t’i pranojmë vendimet e gjyqit si procedura penale, por nuk mund të detyrohemi t’i pranojmë vendimet e tilla si përfundime ideologjike. E dyta, muslimani mund të bindet në argumente vetëm nëse ato bazohen në Kur’an dhe Sunnet. Por në qoftë se Islami ballafaqohet me një Amerikë, Britani, Indi dhe me liderët e tjerë të “vëllazërimit ndërkombëtar”, dhe t’i lusin muslimanët që të heqin dorë nga ato që atyre nuk u pëlqejnë, kurse t’i lënë ato të cilat u konvenojnë, madje kësaj t’ia shtojnë një materie duke menduar se ka nevojë të ekzistojë në Islam, dhe që kështu, pas këtyre përmirësimeve, amendamenteve, ndryshimeve, shtimeve në themelet juridike islame, të prezentuara muslimanëve në emër të Islamit, u dedikohen klasave të larta dhe zyrtare, por prej një muslimani të thjeshtë kjo gjë do të pritej me një indinjatë të hatashme, e cila do të hedhë larg me një urrejtje të madhe”!⁹

Më 25 maj 1955, u përpilua Habeas corpus (E drejta për ta liruar nga burgu Mewlana Mewdudiu në mungesë të provave), nga ana e Gjyqit të Lartë me të cilën ky u lirua nga burgu.

Më në fund, Kushtetuta e Parë e Republikës Islame të Pakistanit u shpall në mars të vitit 1956. Në të u përpilua një brum më i gjerë se sa ishin edhe kërkesat e Xhema’at-e-Islamit. Megjithatë, në mënyrë tragjike, derisa Kushtetuta ishte duke përfunduar që t’i shërbejë shtetit si bazë për

⁹ An Analysis of the Munir Report, Jama’at-e-Islami Publication (botimet e Xhema’atit), Karachi, 1956, p.p. 214-215.

hartimin e një Kushtetute, me urdhrin e 7 tetorit 1958 të presidentit Iskender Mirza, pason dekreti për anulimin e saj. Në të njëjtin muaj, më 17 tetor, feldmaresali Muhammed Ejub Han, rrëmben pushtetin, anulon Gjyqin Ushtarak dhe i ndalon të gjitha partitë politike, duke përfshirë këtu edhe Xhema'at-e-Islamin.

Mewdudiu i pafrikshëm, qëndroi në pozitat e tij për ta zhvilluar kauzën islame. Për inat të Gjyqit Ushtarak, ai udhëhoqi me aktivitetet në rrafshin e publikimeve, tani të përmirësuara, të edicioneve dhe të koleksioneve të zgjeruara të fjalimeve dhe artikujve të tij, të shkruara prej vitit 1939 deri më 1958, të cilat i titulloi “Ligji Islam dhe Kushtetuta”, në të cilat shprehimisht dhe në mënyrë të bindshme, theksoi nevojën për aplikimin e Sheriatit në pushtetin modern islam. Argumentet e Mawlana Mewdudiu ishin aq bindëse saqë edhe krishterët e posteve të larta, siç ishte ministri i Drejtësisë së Pakistanit, A.R. Kornelius, në mënyrë të hapët mbrojti tezën për zbatimin e Sheriatit si sistem i vetëm legal që i përgjigjet vendit. Më 17 shkurt 1957, në Pakistanin Perëndimor u mbajt Mbledhja e Gjyqit të Lartë Qindvjeçar, ku të gjithë gjyqtarët shprehën dëshirën për ta zbatuar Ligjin Islam, si një gjë e pashmangshme.

Më 5-6 maj 1960, Mawlana Mewdudiu, së bashku me 19 ulema të tjerë, të cilët përfaqësonin të gjitha shkollat dhe mendimet islame, u takuan në Lahore ku përgjigjeshin në pyetjet e shtruar nga ana e Komisionit Kushtetues të Qeverisë, ngase deri atëherë sistemi parlamentar në Pakistan kishte dështuar, dhe pastaj këtu u propozua një nevojë e pashmangshme për përmirësimin e disa masave lidhur me përtëritjen e demokracisë dhe të drejtave humane.

Pakistani atëherë ishte në fazën e themelimit të elementeve të një bashkësie islame. Më vonë, falë ndihmës së All-llahut, me këtë, vetëm përcaktimi i një bashkësie muslimane do të garantojë

ekzistencën dhe përforcimin e saj. Jomuslimanët nuk e sollën në pyetje ekzistimin e këtij shteti. Ekzistenca e tij do të vinte në pyetje vetëm nëse mungojnë sakrificat e muslimanëve, por do të qëndrojë dhe do të vazhdojë së ekzistuari në qoftë se All-llahu lejon që ata mos ta humbasin shpresën në Të, por ta lidhin fatin e tyre me Të në jetë dhe të vdesin për Të. Përpos disa nëpunësve të lartë shtetërorë dhe një numri të pavlerë të disa familjeve pasanike, dëshira e magjorancës muslimane ishte që të themelohet dhe të përjetohet lulëzimi i një shteti islam me ligje islame, ku sistemi i edukimit do të ishte sistemi islam dhe kultura e civilizimi i të cilit do të ishin islame. Ky ishte qëllimi për të cilin muslimanët kanë flijuar jetën e tyre, pasurinë dhe nderin për ta themeluar Pakistanin. Nuk mund të jetë bërë krim më i madh ndaj këtij populli dhe vendi se shkatërrimi i këtyre interesave të popullit. Me shkaktimin e hutisë dhe humbjes së iluzioneve të thjeshta në masat e gjera muslimane, a do të ishte në atë moment të pikërishtëm një përkrasje e madhe dorëzimi i pushtetit këtij grupi të vogël edhe për arsye të emrit islam që do ta mbante ky shtet dhe fesë së vërtetë të tij?¹⁰

Kur më 2 mars 1961, Shoqata e Grave të Pakistanit korri sukses për ta bindë Qeverinë që ta miratojë Rregulloren ligjore për Familjen Muslimane e cila deri atëherë ishte në kundërtënie të shprehur me Sheriatin, ku do të viheshin restriksione të mëdha ndaj poligamisë, në fushën e detyrimeve martesore, në përcaktimin kohor minimal legal për martesë dhe në deklarinimin për shkurorezim të njëanshëm me kërkesë vetëm të burrit përkundër mospajtitit të gruas, e cila

¹⁰ Answers to the Constitution Commission's Questionnaire and basic Principles of an Islamic State (Përgjigje Kuestionarit të Komisionit Kushtetues dhe themelet kryesore të një shteti islam), published by Sayed Muhammed Daud Ghaznavi, Lahore, 1960, p.p. 26-27.

trajtohej si e paaftë për këto punë; për këtë, Mawlana Mewdudiu bashkë me 209 ulema të tjerë nga të gjitha anët e vendit, protestonte dhe kërkonte revokimin e këtyre preambulave ligjore, ose së paku, të bëhen plotësime me vërejtje klauzore. Deklaratat e ulemave si opozitë ndaj këtij ligji të ri për familjen, ishin të përcjella me masa shumë të rrepta represive nga ana e pushtetit.¹¹ Personat përgjegjës për shtyp dhe qarkullimi i këtyre materialeve u ndalua dhe shumë prej sish u vënë prapa grilave të burgut.

Mawlana Mewdudiu gjatë kësaj periudhe vazhdonte energjikisht së shkruari dhe predikimi në mënyrë individuale dhe të pavarur. Gjatë viteve 1959-1962, bëri shumë udhëtime nepër Azinë Perëndimore, duke vizituar Arabinë, Sirinë, Jordaninë dhe Egjiptin, bashkë me vendet e shenjta historike të cilat përmenden në Kur'an, pastaj për ta bërë gati në gjuhën urdu vëllimin e gjashtë të përkthimit të tij të Kur'anit si dhe të komentimit, me emrin "TAFHIMUL ul KUR'AN". I filluar në vitin 1943, vëllimi i gjashtë, si vëllim i fundit i "Tafhimul-ul-Kur'anit", u kompletua në qershor të vitit 1972, i cili në botën islame shumë u kërkua. Për t'i plotësuar nevojat e mëdha të kërkesave, kjo vepër u përkthye në gjuhën angleze, arabe, në bengale dhe pashto. Në "Tafhimul-ul-Kur'an" Mawlana Mewdudiu ka dhënë prova të gjalla për të Vërtetën Absolute dhe superioritetin e drejtimit islam të jetës ndaj të gjitha drejtimeve të tjera, duke tërhequr vërejtjen në faktin se qysh hebrenjtë dhe të krishterët i kanë shtrembëruar librat e tyre të shenjta. Komentimi i Mewdudiu të sureve en-Nur dhe el-Ahdhab, u publikua në veçanti me qëllim që të tregohet mënyra se qysh

¹¹ Deklarata e 209 ulemave të Pakistanit përkitazi me Ligjin e Familjës muslimane (Statement of 209 Ulema of Pakistan on the Muslim Family Law) Ordinance, edited and translated by Mian Tufail Muhammed, Lahore, 1962.

dënimet për krime në Islam janë më humane dhe më efektive se çdo ligj penal sekular, që është prodhim i njeriut, kështu që kjo vepër u kërkua shumë të lexohet nga ana e studentëve të arteve të lira dhe të drejtësisë në koxhjet dhe universitetet e Pakistanit. Mawlana Mewdudiu gjithashtu ka qenë udhëheqës i hulumtimeve të haditheve në kuadër të veprës së tij “SUNNET KI AJINI HAIJIAT” (Pozita ligjore e Sunnetit) në të cilën ashpër janë dënuar Ser Sajjid Ahmed Han dhe Ghulam Ahmed Parvez, të cilët nuk kanë pranuar besueshmërinë e Traditës së Pejgamberit.

Më 1961, me kërkesën urgjente të mbretit ibën Saud të Arabisë Saudite, Mawlana Mewdudiu përpiloi i pari skemën për themelimin e një universiteti islamik në Medine për të cilin ai besonte se eventualisht do të plotësojë një vakuum intelektual dhe edukativ, të krijuar në kushtet kur karakteri islam i Universitetit të Az-harit është tretur nga nacionalizmi dhe sekularizmi.

“Skema e hartuar nga unë dhe e aprovuar nga Komiteti i emëruar nga ana e Mbretit për Universitetin Islam të Medines, parashihte të studiohen këto lëndë: Kur’ani, hadithet, Fikhu (jurisprudenca), historia islame, Kelami (teologjia) bashkë me Ligjin modern, politika, ekonomia, historia komparative e religjioneve. Pos anglishtes, gjuha frënge dhe gjermane duhet të jenë të obligueshme. Arsimi i paraparë në këtë skemë nuk ka të bëjë asgjë me atë sekular dhe me mësimin e thjeshtë dhe të ngushtë të religjionit. Ky universitet do të dallohet nga të gjitha institucionet e vjetra dhe ato moderne, kështu që do të ketë një fizionomi të veçantë. Ne dëshirojmë që prej tij të dalin shkollarët muslimanë, të cilët duhet t’i kombinojnë mësimet islame

me ato moderne dhe të cilët do të jenë kompetentë t'i zbatojnë ato në parimet islame në fushën e problemeve të jetës së përditshme”¹².

Kur në vitin 1963 u acaruan marrëdhëniet midis Egjiptit dhe Arabisë Saudite, mbreti refuzoi ta pranojë punimin egjiptian njëvjeçar të prodhuar nga një cohë e zezë për ta mbuluar Shtëpinë e Shenjtë të Qabesë. Atëherë Mewlana Mewdudiu ndërhyri dhe ofroi shërbimin për ta thurë këtë cohë në Pakistan. Mbreti u pajtua me këtë propozim, dhe atëherë, nën mbikëqyrjen e Mewlanas u thur mbulesa e zezë e quajtur KISVA, si një punëdore e shkëlqyeshme, e qëndisur me fije ari nga ana e zanatçinjve më të njohur të Lahores. Kur u krye ky punim në mars të atij viti, dy trena specialë, të udhëhequr nga aktivistët e Xhema'at-e-Islamit, të ngarkuar me shumë vagona, u nisën nga Lahora për në Kueta, mandej prej Kuetës për në Karaçi, Lahore dhe Peshavar, dhe prej Peshavari prap për në Karaçi, duke e kaluar tërë Pakistanin Perëndimor. Kjo gjë shkaktoi një tollovi të paprecedent në mesin e besimtarëve të entuziazmuar nga i gjithë vendi, nga gati të gjitha katundet dhe qytetet u vërsulën në drejtim të stacioneve hekurudhore, nënat me foshnja, fëmijët me njerëz të të gjitha moshave nga çdo vendbanim, në turma prej qindra dhe mija vetash, pritnin të tensionuar gjatë disa ditëve me radhë. Kur më në fund arrinte treni që e bartte Kisvanë, aktivistët e Xhema'atit tentonin që këtë ta mbajnë lartë në duar për ta parë të gjithë të pranishmit. Në atmosferë të lutjeve dhe qarjeve nga ekstaza e gëzimit, ai i cili gjendej afër pa pra puthte mbulesën e shenjtë, të cilën e lagte me parfum. Kur më në fund Kisva arriti në aeroportin e Lahores aty ishin duke pritur më se një milion njerëz, të cilët i mbushën përplot të gjitha hapësirat

¹² Correspondence between Mewlana Mewdudi and Meryem Jemile, op. cit. p. 22 (Korrespondenca ndërmjet M. Mewdudiu dhe Merjem Xhemiles, faqe 22.

e rrugëve, duke recituar versete kur'anore, me shpresë se së paku një herë do ta shohin Kisvanë. Në aeroport Mawlana Mewdudiu ia tregoi Kisvanë ambasadorit të Arabisë Saudite, i cili për këtë i shprehu mirënjohje.

Xhelozë për shkak të rritjes së popullaritetit dhe ndikimit të Mawlana Mewdudiu, armiqtë e tij tentonin gjithkund që ta sabotojnë bile edhe Mbledhjen vjetore të Xhema'at-e-Islamit, të mbajtur më 25-28 tetor 1963. Bashkë me pengesat tjera, armiqtë e tij u përqëndruan në sabotime të tilla që mos t'u japin leje njerëzve për të shkuar në mbledhje, bile refuzonin që t'i jipet Mewlanas mikrofoni, por prapëseprapë, konferenca u mbajt në praninë e më se 10.000 vetave. Huliganët, nën mbrojtjen e policisë, tentuan që ta djegin sallën e konferencës ose ta vrasin Mawlana Mewdudiu, por me guximin e tij dhe durimin e aktivistëve të Xhema'atit, mbledhja përfundoi me sukses.

Kjo situatë nuk mund të tolerohej nga ana e kundërshtarëve të tij, andaj vazhduan ta sulmojnë me një propagandë të ashpër në shtypin zyrtar, e cila arriti kulmin më 6 janar 1964 kur të gjithë liderët e njohur të Xhema'atit përsëri u arrestuan dhe u burgosën pa gjykim. Me këtë iu ndalua aktiviteti Xhema'at-e-Islamit dhe u cilësua si një shoqatë jashtligjore, së cilës iu mbyllën të gjitha zyrrat, libraritë, kurse vendet e takimeve u mbyllën dhe u vulosën nga ana e policisë. Megjithatë, së shpejti ky rast u paraqit në Gjyqin Suprem të Pakistanit që në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të dëgjohej vendimi për ndalimin e aktivitetit të Xhema'atit dhe të burgosjeve të liderëve të partisë, i cili u cilësua dhe u anulua si i pavlefshëm. Vetëm 15 ditë pas lirimit të tyre nga burgu, më 25 tetor 1964, gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhje presidenciale, Mawlana Mewdudiu iu lejua që të mbajë një fjalim dyorësh në Lahore para një mase të madhe, ku me

argumente të gjalla sulmoi politikën e regjimit, bile me këtë i bëri sfidë regjimit për legjitimitetin e të drejtave të tij për të qëndruar në pushtet.

“Krimi jonë më i madh është që ne jemi hipokritë kur është fjala për besimin tonë në Islam, për atë ne i kemi shtruar qysh herët objektivat për një aktivitet cilësor të shoqërisë, në mënyrë që ato të jenë në vijën e parimeve të Islamit. Kur predikojmë se Islami është feja jonë, natyrisht se duhet përcjellur Islamit dhe vetëm Islami mund të jetë udhërrëfyese ynë në të gjitha fushat e jetës, është një moral që na prinë, besim dhe ideologji, etikë dhe edukim, rend shoqëror dhe parim kulturor, sistem ekonomik ose strukturë politike, ligjshmëri dhe drejtësi, si në marrëdhëniet e brendshme ashtu edhe në ato ndërkombëtare. Çdo ndikim më i vogël i të huajit të korruptuar duhet të shlyhet nga jeta jonë individuale dhe kombëtare. Ne nuk mund të tolerojmë asnjë kompromis në këtë kuptim, jemi të përcaktuar ta praktikojmë vetëm atë të cilën e besojmë. Ata që duan të bëjnë një truk në emër të Islamit, vetëm bëjnë një vepër shumë të fëlliqur. Politika e tyre është shfrenuese kundër Islamit në çdo hap të jetës, ata vazhdimisht nuk e kanë qëndrimin e sigurtë ndaj problemit të kombit kur dihet se i është nënshtruar gënjeshtrevë”. “Krimi i dytë ynë përqëndrohet në faktin se ne përpiqemi të krijojmë njeriun me një karakter të fortë. Popullin mund ta marrim nënsqetull vetëm pas njohjes së tërësishme të tij dhe atë i cili do t’i bashkojë Xhema’ati-e-Islamit pas një bindjeje të thellë për vetëdijen ideologjike, dhe pastaj ky vetë ta zgjedhë drejtimin tonë, dhe tërë jeta e tij duhet t’u përmbahet këtyre parimeve. Ai nuk duhet të kënaqet vetëm me një deklaram të thjeshtë verbal se është besimtar, por duhet të qëndrojë në pozitë se është i denjë për profesionin që e ushtron, dhe të insistojë që ta ndryshojë edhe qëndrimin bashkë me sjelljet e veta. As persekutimet e ndryshme e as tirania ata nuk mund t’i ndryshojnë. Mund ta shfaqin haptas mendimin se çka është mirë e çka është keq. Burgu për ta

nuk është gjë që i frikëson. Kjo duhet të jetë si rrjedhojë e natyrës së ushtruar të tyre morale dhe shpirtërore.”

“Unë tani jam duke e ngritur akuzën kundër presidentit Muhammed Ejub Han, ku me fakte të gjalla e akuzoj se për ç’arsye ai deri më sot nuk ka bërë asgjë prej vendimit të Gjyqit Ushtarak, dhe kjo, sipas mendimit tim, është një shkelje për të cilën ai nuk meriton të bëhet president i Pakistanit.”

“Para së gjithash, ai shpërdori detyrën dhe me këtë tregoi se është fajtor hiç më i vogël se një kriminel i cili shpërdor besimin që i është dhënë. Kombi pat ushqyer besim në të dhe e përkrahu kur ishte kryekomandant i armatës. Por, ai me armatën bëri grusht shtet dhe e hodhi poshtë Kushtetutën e vendit. Çfarë të drejte kishte për ta bërë këtë dhe ta marrë pushtetin në duar duke e shfrytëzuar armatën, të cilën e pat vënë nën komandën e vet për ta mbrojtur vendin? Nëse Ejub Hani kishte ndonjë njohuri rreth çështjeve politike ose nëse kishte ndërmend ndonjë ide për ta përmirësuar gjendjen në vend, ai më parë duhej të jipte dorëheqje nga posti i kryekomandantit dhe ta tërhiqte proklamatin e tij për kontestimin e votimeve të parapara në vend për shkurt të vitit 1959”.

“Krimi i dytë i kryer nga ana e Ejub Hanit është ai me të cilin flaku Kushtetutën demokratike të proklamuar në vitin 1956, për të cilën, sipas rregullave, u përbetua se do ta mbrojë gjatë katër viteve. Gjatë kësaj periudhe, populli mbeti i privuar nga të drejtat themelore, kurse në ndërkohë, ai ende miratonte ligje dhe rregullore të cilave vetë nuk u përmbahej. Konstituo i Gjyqin Ushtarak, po ashtu edhe gjyqet civile dhe ato kundër krimeve, ku gati të gjitha funksionet e tyre

përqëndroheshin në gjykimet e shkurtra, me anë të të cilave mbi popull ushtroheshin ndëshkime të rënda.”

“Krimi i tretë i Muhammed Ejub Hanit është se ai gjatë periudhës së Gjyqit Ushtarak e ushtronte sistemin e demokracisë themelore sipas dëshirës së tij, dhe i mbështette zgjidhjet vetëm për vete, atëherë kur asnjë parti politike nuk kishte të drejtë të nxjerrë proklamata ose të mbajë diskutime politike. Po ashtu, edhe për të folur për politikën dhe për t’u përzier në aktivitetet politike konsiderohej si faj i madh, për të cilin ishte paraparë dënimi prej 14 vjet burg të rëndë. Çfarë atmosfere e përshtatshme për votime për demokracinë themelore! Gjatë votimeve disa mijëra demokratë u pyetën se a do t’ia japin votëbesimin Ejubit. Gjatë fushatës elektorale nuk ka patur kandidatë tjerë.”

“Me rastin e votimeve të kurdisura, Ejubi nuk i pyeste ata 80.000 “demokratë nga baza” për ta emëruar atë për president, por kërkonte prej tyre të bëhen autoritete të besueshme për hartimin e një kushtetute sipas dëshirës së tij. A kishte ky arsytim të bëjë diç të tillë? Gjatë periudhës së votimeve për një demokraci themelore, popullit nuk i është thënë asnjëherë se personat e zgjedhur në këtë mënyrë kanë të drejtë ta zgjedhin vetë presidentin, kështu që presidentit kur i vinte radha të bëjë diç, ai vetveten e autorizonte ta bëjë kornizën e Kushtetutës. Ishte fare e qartë se këta 80.000 “demokratë nga baza” nuk kishin mandatin e popullit për një gjë të tillë.”

“Tani i siguruar me pushtet për ta hartuar kornizën e Kushtetutës, “Presidenti i plotfuqishëm” dhe Kryetar i Gjyqit Suprem të shtetit, emëron Komisionin kushtetues me rekomandime rreth kushtetutës së ardhshme. Të gjithë kandidatët e këtij komisioni ishin emëruar nga vetë presidenti.

Nga ana e popullit nuk kishte asnjë përfaqësues. Shprehjet për çdo pikëpamje politike ishin të ndaluara, përpos atyre që kishin të bëjnë me presidentin dhe ministrat e tij.”

“Megjithë këto kërcënime, në raportin e komisionit Kushtetues theksohej se është e pranishme një rritje e madhe në popull e peshës për aspiratat demokratike. Konsekuent kësaj, Ejubi i hodhi këto rekomandime në shportë dhe doli para opinionit me një kushtetutë në të cilën shprehet “gjenialiteti i tij”. Kushtetuta e vitit 1962, në të cilën problemet e vendit nuk e pasqyronin gjendjen e vërtetë, ishte projektuar deri në fund kundër dëshirës dhe aspiratave të popullit, e cila as që bazohej në rekomandimet e Komisionit kushtetues, dhe si e tillë, ishte pranuar nga Ejub Hani. Në Kushtetutë ishte mishëruar dëshira e vetme e një personi. Ishte e plotfuqishme për vendin derisa ishte në fuqi Gjyqi Ushtarak.”

“Tani le t’i hedhim një sy Kushtetutës së cilës i gjithë kombi duhej t’i bëjë nderë të përhershëm dhe t’ua paguaj hartuesve haraçin. Në këtë Kushtetutë, i gjithë pushteti ishte i koncentruar në duart e një individi-Ekzekutorit Kryesor! Ai vetë prej qendre kontrollonte tërë makinerinë ekzekutive, edhe nëse paraqitej nevoja për provincat e largëta, ai vetë i emërtonte guvernatorët dhe i shkarkonte kur i tekej, edhe pa pasë për këtë ndonjë arsye.”

“Tani le ta analizojmë faktin se çfarë lloj lirie të shprehjes dhe të organizimit na dha Ejubi. Asnjë sistem politik nuk mund të veprojë në mënyrë të drejtë përderisa populli është i privuar nga informimi i vërtetë për veprat e shtetit në vend, dhe derisa nuk është i lirë t’i kritikojë punët e këqija të pushtetit, derisa nuk ka mundësi të duhur ta përdorë aftësinë e penës, shprehjes dhe organizimin për mobilizim të fuqive me të cilat i mbron të drejtat themelore të tij kundër sulmeve të fuqisë së tiranisë.”

“Pikësëpari, zëri i shtypit ishte i ngulfatur. Me ndalimin e shtypit, popullin e kanë privuar nga liria e të shprehurit. Kështu, meqë vendi u shndërrua në një fushë të varreve politike, shtypi, platforma politike, radioja dhe e gjithë makineria propagandistike e shtetit, kishte aftësi të këndojë vetëm një melodi: “Qoftë lavdëruar vetëm presidenti Ejub Han”. Historia e së kaluarës dhe e diktatorëve aktualë këtu është duke u përsëritur. Çdo gjë është pasqyruar me qarkullimin rreth një njeriu.”¹³

Gjatë invadimit tradhtues të Indisë mbi Pakistanin që u bë prej 6 deri më 24 shtator të vitit 1965, Mewlana Mewdudiu mbajti pesë fjalime përmes Radio-Pakistanit në Lahore, kur bëri thirrje për një xhihad të drejtë në luftë për ta mbrojtur atdheun. Kontributi i këtyre thirrjeve për aksion luftarak nuk mund të nënçmohet.

Mewlana Mewdudiu nuk kurseu mund për ta siguruar çështjen e të drejtës për Kashmirin. Fjalimi i tij përmes Radios-Azad Kashmir në Muzafferabad, thellë i goditi krimet e Indisë kundër muslimanëve të Kashmirit. Mewlana Mewdudiu i kundërshtoi të dy propozimet e Kombeve të Bashkuara rreth urdhrit për ndaljen e zjarrit, i cili u aplikua më 24 shtator 1965 dhe Deklaratën e Tashkentit të 10 janarit 1966, me të cilën erdhi në shprehje fitorja e plotë diplomatike e Indisë, dhe me këtë u bë e pamundur zgjidhja e problemit të Kashmirit.

Fuqitë e mëdha të botës nuk treguan kurrfarë interesi serioz për problemin e Kashmirit. Kjo situatë u shkaktua me qëllim nga ana e anglezëve kur e dorëzuan pushtetin në nënkontinentin

¹³ The Political Situation in Pakistan, Abul Ala Mewdudi, Jama'at-e-Islami, Karachi, 1965, p.p. 24-41. abrigod (shkurtim).

Indo-Pakistanez, dhe për shkak të përkrahjes në çdo mënyrë, nga ana e Kombeve të Bashkuara që i ofrohej Indisë, por edhe nga ana e Bashkimit Sovjetik. Ata jo vetëm që nuk bënë presion mbi Indinë që të pranojë një zgjidhje të drejtë rreth këtyre mosmarrëveshjeve, por, përkundrazi, vazhdimisht e përkrahnin Indinë me qëllim që t'i ruajë këto pozita.

Që të dy fuqitë e mëdha përkrahën rritjen permanente dhe lulëzimin ekonomik të Indisë të cilën me çdo gjë e furnizonin, e nga ana e vet Bashkimi Sovjetik e ndihmonte Indinë kohë pas kohe, me përdorimin e vetos në Këshillin e Sigurimit, sidomos ndaj dhënies së përkrahjes së rezolutave që kishin të bëjnë me çështjen e Kashmirit. Në të vërtetë, shihej se këto dy fuqi mbështetnin ndihmat që i bëheshin Indisë si një fuqie imperialiste, e cila do t'i përfaqësojë interesat e tyre në këto anë të botës. Së bashku, SHBA-të dhe BRSS-ja përpiqeshin me të gjitha forcat ta bëjnë Indinë një fuqi të madhe ushtarake si kundërpeshë Kinës, dhe në këtë kuptim, ndihmonin që këtë shtet ta zhvillojnë në një fuqi bërthamore. Në këto rrethana, çdo gjë ishte pa shpresë që të pritët prej këtyre dy fuqive të mëdha ta zgjidhin problemin e Kashmirit. Çdo lloj shprese ose mendim që mund të ushqente njeriu në këtë drejtim, flakej në fund me Deklaratën e Tashkentit, në të cilën shprehej haptas interesi i BRSS, i mbështetur me të gjitha forcat nga SHBA-të, me qëllim që të ngrihet çështja e Kashmirit deri në shkallën e “përqaqimit vdekjeprues” dhe që Kashmiri të mbetet nën okupim.”

Ndaj, xihadi për ne ishte solucion i vetëm, dhe përkitazi me këtë, shumë luftëtarë trima të Kashmirit ishin të gatshëm ta flijojnë jetën dhe pasurinë e tyre, duke u përgatitur për vuajtje të papërshkrueshme në luftë që vetë ta zbërthejnë këtë problem. Mundësia e fundit që shtrohej para nesh lidhur me ndihmën që i duhej Kashmirit, ishte sigurimi i gjerë dhe efektiv i publicitetit rreth shpjegimit objektiv të situatës në Kashmir, si dhe përpjekja maksimale e mundësive për ta

mobilizuar opinionin e gjerë të botës në të mirë të të drejtave për vetëvendosje të popullit të Kashmirit; për zgjimin e vendeve të Botës Islame dhe vendeve të vogla aziatike dhe afrikane, për t'i kundërshtuar Perandorisë Induse, duke ua bërë me dije që mos të ushqejnë iluzione përkitazi me këtë problem, që vetë të përgatiten kundër këtij kërcënimi, dhe që ta mbështesin ndihmën morale dhe materiale ndaj popullit të Kashmirit, në mënyrë që ky të jetë i aftë që ta çlirojë veten nga zgjedha e Indisë, që ta përcaktojë në mënyrë të lirë fatin e vet në përputhje me idealet vetjake.¹⁴

Kur Izraeli bëri agresion të pashpirt kundër Sirisë, Egjiptit dhe Jordanisë më 5 - 9 qershor të vitit 1967, Mawlana Mewdudiu e mobilizoi tërë energjinë për t'i ndihmuar vëllezërit e vetë arabë në drejtim të çlirimit eventual të Palestinës nga okupimi cionist, dhe sidomos të qytetit të shenjtë Jerusalemit.

“Kushtrimi i bërë me këtë rast gjithë botës islame, kishte për qëllim që të përkrahen arabët dhe t'u bëhet një mbështetje e fortë dhe përcaktim pa rezervë për kauzën e tyre. Me këtë kërkohej nga njerëzit e drejtë të botës një përkrahje e pranimit të parimeve se kurrkush nuk mund të pushtojë një vend sikurse që as me forcë e as me luftë nuk mund të pranohet ndryshimi i kufijve të një vendi. Në këtë vazhdë, ne duhet të formojmë një front unik, përndryshe pasojat e tmerrit nuk do të mund të paramendoheshin. Në qoftë se vendet muslimane do ta injoronin sfidën çifute në formë qysh është duke u bërë, në të ardhmen duhet pritur një shkatërrim”.

¹⁴ Kashmir: A Call to the Conscience of Humanity, S.A. Mewdudi (Një thirrje për koshiencën humane), Jama'at-e-Islami, Lahore, February, 1966, p.p. 53-55, abridged.

“Ne duhet të bëjmë një plan të gjerë për t’i zbutur pasojat e mundshme nga kjo disfatë, me të cilin duhet t’i luftojmë faktorët themelorë që ishin shkaktarë për një përdhosje të tillë. Kjo luftë mund të quhet nga ana e dikujt si luftë vetëm arabo-izraelite, dhe disfata që e vuajnë arabët do të mund të quhej disfatë e tyre, por fakt i gjallë është se ky qëndrim në mënyrë të tmerrshme do t’i shkaktonte prestigjit, nderit dhe sigurimit të gjithë popullsisë muslimane dëm të madh karshi botës. Okupimi cionist i qytetit të vjetër Jerusalemit, shenjat e dukshme për demolimin e Mesxhidi Aksasë, dhe në vend të saj ndërtimi i një tempulli të Solomonit, nuk janë katastrofë e cila do të kufizohej vetëm tek arabët. Kjo paraqet një plagë të rëndë për çdo shpirt musliman, çështja e qytetit të shenjtë Jerusalemit, nuk u takon vetëm arabëve; të gjithë muslimanët atë e nderojnë si Kiblën e Parë të tyre. Më vonë, ne do ta përjetonim planin e ekspansionistëve hebrej agresivë në përmasa botërore, me kërcënimin e qyteteve të shenjta të Mekkes dhe Medines. Kjo mundësi paraqet një çështje serioze për ne, një rrezik të mundshëm shumë të madh jo vetëm për arabët, andaj situata është e padurueshme edhe për të gjithë muslimanët e botës”.¹⁵

Prej se Izraeli bëri këtë agresion të pashpirt kundër Egjiptit, Sirisë dhe Jordanisë më 5-9 qershor të vitit 1967, Mewlana Mewdudiu e mobilizoi tërë energjinë e vet në përkrahjen e vëllezërve arabë, për çlirimin e Palestinës dhe objekteve sakrale të qytetit të shenjtë Jerusalemit nga okupimi cionist.

¹⁵ “How to meet the (Palestinian) Situation”, Seyyid Abu Ala Mewdudî, The Middle East Crisis, Chaudhry Ghulam Muhammed, Chiragh-e-Ragh Publications, Karachi, March 1968, p.p. 161-163, abridged. (Si e çmojmë situatën e Palestinës, S.A.A. Mewdudî; Kriza e Lindjes së Mesme, Çaudri Ghulam Muhammed, Çirag-e-Ragh botimet, Karaçi, mars 1968....)

Në mars të vitit 1966 Mbledhja e Rabitas (Kongresi Botëror Islamik) e mbajtur në Mekke, e përkrahu Mewlana Mewdudiu, si njërin nga themeluesit e kësaj organizate, me mendimet e tij të shtruar rreth organizimit urgjent të forcave vetjake ushtarake të vendeve muslimane, duke lënë anash mbështetjen e Amerikës, të Bashkimit Sovjetik ose të ndonjë fuqie tjetër të jashtme. Ai u bëri thirrje të gjithë muslimanëve të botës që ta injorojnë nacionalizmin dhe të bashkohen në një bllok të vetëm për ta mbrojtur veten edhe kauzën islame në çdo vend. E proklamoi Islamën si ideologji e vetme e aftë për bashkimin e të gjitha racave dhe kombeve brenda një familjeje, e cila është në gjendje t'u shërbejë të gjitha shteteve si bazë për të sjellë drejtësi të përhershme dhe paqe universale.

Islami nuk paraqet një koncept të barazisë së njeriut të bazuar në një filozofi përtace. Ai paraqet një shoqëri të bazuar në këtë koncept: Shoqërinë Islame e përbëjnë grupe njerëzore të racave të ndryshme, të kombeve të ndryshme, duke u themeluar kjo në një barazi të plotë të të gjithë individëve. Në Islam të gjitha racat, ngjyrat, gjuhët ose kombet janë të barabarta dhe çfarëdo dallimi në mes tyre nuk ekziston. Pos kësaj, Islami gjithashtu ka përjetuar të ketë një lloj shteti në botë të bazuar në ideologji të njëjtë, funksionimi i të cilit ishte me plot sukses. E gjithë Bota Islame ka qenë e udhëhequr nga i njëjti ligj. Të gjithë muslimanët ishin sikur një familje. Nëse një person joislam, qoftë në Perëndim, e ka pranuar Islamën, ai menjëherë është kooptuar si anëtar i shoqërisë islame dhe i ka gëzuar të gjitha të drejtat dhe privilegjet. A ka qenë ai zezak, iranian, kopt ose berber, në mënyrë imediate ka qëndruar në themelet e njëjta të shoqërisë islame pas pranimit të Islamit, dhe është konsideruar si të ishte pjesëtar i farefisit të Pejgamberit të Shenjtë (paqja qoftë mbi të) ose i shokëve të tij arabë. Statusi i tij shoqëror ishte i njëjtë me atë të tyre. Mund të fitonte pozita më të larta në shoqërinë islame në bazë të cilësive morale dhe të

drejtave të tij. Besimtari islam, pa marrë parasysh prejardhjen e tij racore, origjinën e vendit, gjuhën amnore ose ngjyrën, është vëlla i të gjithë muslimanëve të tjerë, dhe kudo që të qarkullojë nëpër shoqërinë islame, i gëzon privilegjet e njëjta sikurse muslimanët e tjerë. Një musliman nga çdo pjesë e botës, mund të shkojë në çdo vend islam pa kurrfarë pengesash, lirisht të lëvizë prej një vendi në një vend tjetër, të qëndrojë sa të dojë, të merret me çdo punë prodhuese, mund të sigurojë edhe postin më të lartë në administratë dhe mund të martohet pa asnjë pengesë. Historia islame është përplot me shembuj të tillë kur një musliman e ka lëshuar vendin e vet dhe ka jetuar me dekada në një vend tjetër (vend islam). Ka pasë mundësi të studiojë aty, të merret me tregti në një vend tjetër, të bëhet ministër ose kryekomandant i ushtrisë në një vend të tretë, dhe ka mund të shkojë bile edhe në një shtet krejt tjetër islam, të bëhet banor i tij dhe të krijojë familje. Për këtë, shembull i mirë ka qenë Ibën Batuta i njohur, i cili ka udhëtuar 27 vjet me radhë nëpër shumë vende islamike. Për t'i vizituar ato vende nuk ka patur nevojë për pasaportë ose viza. Askund nuk e kanë pyetur për prejardhjen e tij kombëtare. Në asnjë vend nuk ka hasur në pengesa lidhur me sigurimin e të ardhurave për jetesë. Nuk ka patur nevojë për ndonjë leje të veçantë për vizitat e vendbanimeve të ndryshme gjatë gjithë udhëtimeve që i ka bërë. Në rast se diku ka kërkuar punë, emërohej menjëherë pranë çdo administrate pa kurrfarë pengesash. Gjatë sundimit të sultan Muhammed Tuglakut ai jetoi në Indi. Vetë fakti që mori ato udhëtime të largëta, duke u nisur prej Marokut, vendlindja e tij nuk paraqiste pengesë për emërimin e tij në cilësi të gjyqtarit në Indi. Pas një kohe, sultani e dërgoi në Kinë në cilësi të ambasadorit të tij. Këto prova sheshazi tregojnë faktin se nuk ka patur asnjë kufizim në veprimtarinë e tij, deri në shërbimet diplomatike. Këto fakte tregojnë se ajo kohë nuk cilësohej si ide të krijohen raportet sikur të ishte fjala për ndonjë komonvelt, por tregohet shumë operative e drejta e një qytetari. Pushteti në botën islame ishte i ngjashëm në të gjitha vendet muslimane. Mbrojtja dhe ruajtja e

botës islame ishte një nga detyrat e përbashkëta për të gjithë muslimanët. Një gjendje e tillë mbisundonte në botën islame deri në fillim të shekullit XIX. Çfarë prove më e madhe në botën islame duhet të jetë se themelet e forta të shtetit që ishin bazuar në teorinë dhe praktikën e ideologjisë islame, të cilën gjë aktualisht e admirojnë mendimtarët? Faktikisht, kjo gjë ka ushtruar ndikim të madh që të ekzistojnë në këtë mënyrë shumë vende (p.p. 19-24).

“Kudo që të shkojmë, prej Indonezie e deri në Marok, shohim se muslimanët disponojnë me një kulturë, e cila i trajton të gjithë besimtarët në mënyrë të njëjtë. Vlerat fundamentale të kësaj kulture manifestohen në formë të njëjtë në të gjitha vendet muslimane. Kudo që të jetë, në çastin kur dëgjon ezanin për t’u falur, muslimani bëhet i vetëdijshëm se ndodhet në mesin e vëllezërve të fesë. Ai ka të drejtë të bëhet anëtar i një xhemati në xhami sikurse ata që janë të vendit. Askush nuk e konsideron si të huaj kur e shohin se falet. Shpeshherë njerëzit nxitojnë për ta përqaftuar kur marrin vesh se ky ka ardhur nga një vend islamik. Mund të mos e njohë gjuhën e tyre, por një “Esselamu alejkum” i thjeshtë, paraqet formën më të përshtatshme për njohje ndërmjet vete. Prej Indonezie e deri në Marok, forma dhe kënaqësia e foltorëve është e njëjtë. Xhemati këtë mund ta lusë ndonjëherë që t’u bëhet imam për ndonjë namaz. Mirëpo, edhe ky si “i vetmuar i huaj” mund ta lusë xhematin që namazit t’i prijë imami i përhershëm i tyre. Kudo që të shkojë jashtë xhamisë, në mjedisin musliman mund t’i gjejë lidhjet kulturore të njëjta që atë e lidhin me muslimanët e një vendi. Mund të ushqehet së bashku me ta fare i sinqert dhe i vetëdijshëm se të gjitha ato lloje të ushqimeve që janë të ndaluara dhe të anatemuara për të, njëkohësisht vlejné edhe për ata. Rregullsia për pastërti kultivohet njësoj si tek ata po ashtu edhe tek ai. Cilindo vend musliman që mund ta vizitojë, pa marrë parasysh a është në një mjedis të elitës shoqërore ose në atë të popullit të thjeshtë, mund ta zbulojë faktin se pa marrë parasysh standardin jetësor të

popullsisë në një vend islamik, muslimani i huaj konsiderohet sikur të ishte ilaka me popullsinë e vendit. Nëse dëgjojnë se në vendin e tij populli është duke jetuar mirë, ata e lusin All-llahun që atyre t'u sjell rehati dhe mirëqenie, dhe fytyrat e tyre mbushen me shkëlqim nga gëzimi. Por, nëse dëgjojnë se situata në vendin e tij nuk është e mirë, atëhere ndihen keq për bashkëvendësit e tij, sikur atyre vetë t'u kishte ngjarë një gjë e tillë. Jo vetëm kaq. Të gjitha ligjet shtetërore në vendet islamike janë të ngjashme si bie fjala, për martesë, shkurorëzime, trashëgime, gjë që tregon për faktin se një banor i një vendi musliman nuk mund të hasë në pengesa për t'u martuar me një banorë të një vendi tjetër islamik. Këso raporte nuk ekzistojnë në vendet tjera të botës joislame. Të gjitha këto janë prova se në vendet muslimane ekzistojnë raporte të forta të bazuara në ndjenja të përbashkëta, të cilat nuk ka forcë që mund t'i mposhtë, bile edhe në këtë periudhë të kultit të nacionalizmit. Aq më tepër, të gjitha vendet islamike, prej Lindje në Perëndim, paraqesin një kontinuitet të pandarë gjeografik. A thua, përse këto vende nuk i bashkojnë fuqitë e veta për t'i zgjidhur problemet e përbashkëta dhe nuk ndihmojnë njëri-tjetrin për të ecur përpara dhe për t'u zhvilluar? (p.p. 33-35).

Njeriu befasohet me ata që e kundërshtojnë bashkimin e vendeve islamike që janë kaq të ndara në mes vete, për arsye se kanë një fe të përbashkët. Është gjë e çuditshme kur njerëzit bashkohen në emër të komunizmit, duke menduar se ky akt është i urtë dhe i pranueshëm; ose je e logjikshme është edhe cilësia e ngjyrës së lëkurës për bashkimin e njerëzve dhe se vetëm bashkimi në emër të Zotit dhe besimit ndaj Tij, paraqet marrëzi (p. 33). Tani mund të shohim se nëse muslimanët do t'i gëzonin të drejtat për të vendosur për fatin e tyre, armiqtë e tyre do ta merrnin përsipër përhapjen e predikimit të nacionalizmit midis muslimanëve, me të cilën gjë ata besojnë se do t'i pengojnë muslimanët në forcimin e lidhjeve të tyre për bashkim. Fuqitë e mëdha nuk ngurrojnë, e

po ashtu edhe cionizmi dhe imperializmi indus, ta tregojnë veten si faktorë kundë rizgjimit islamik dhe bashkimit të muslimanëve. Sikur muslimanët, njëherë t'i kishin ngjeshur radhët e tyre, do të vinte fundi i sundimit dhe shfrytëzimit të vendeve muslimane (supozohet që numri i muslimanëve arrin rreth 600 mil -1,6 mil.-vërejtje për vlerë). Cionistët janë në dijeni të mirë për bashkimin e muslimanëve, dhe se fundi i Izraelit nuk mund të jetë shumë i largët. Këtë frikë e ndajnë bashkë me ata që janë duke ëndërruar për dominimin e indusëve si shumicë, dhe ndikimin e tyre në Afrikë dhe Azi. Fuqitë imperialiste janë të vetëdijshme se ky bashkim do t'ua pamundësojë lojën me fatin e vendeve muslimane siç e kanë praktikuar në të kaluarën, me plasimin e spiunëve të tyre në pushtetet muslimane (p. 43). Në këtë kaos i cili është duke e ngulfatur botën aktuale muslimane, prapëseprapë thirrja për një mbledhje islame ka dhënë shpresa të mëdha. Ndaj, muslimanët duhet të tregojnë ndjenja miqësore dhe bashkëpunim me ata, pa marrë parasysh nga do të vinte kjo dukuri, ata duhet edhe të jenë vigjilentë ndaj fuqive të mëdha, të cilat gjithmonë qëndrojnë në pozita të shfrytëzimit të prapambeturisë dhe mospajtimeve në vendin tonë. Faktikisht, ky duhet të jetë shkas më i madh për një pajtim të muslimanëve në mes veti, aq saqë fuqia e secilit do të bëhej fuqi për ne të gjithë. Ky drejtim paraqet rrugën në të cilën muslimanët do të bëheshin të aftë për ta ruajtur sovranitetin e tyre, të luajnë një rol të rëndësishëm dhe konstruktiv në raportet ndërkombëtare dhe t'i sjellin botës një rilindje të kultivuar” (p.p. 44-45).¹⁶

¹⁶ The Unity of Muslim World (Bashkimi i Botës Islame), Seyyid Abul Ala Mewdudi, Islamic Publications, Lahore, July, 1967.

Ku qëndron arsyeja e prapambeturisë së botës aktuale muslimane? Në fjalimin e mbajtur në Xhemiati-ul-Tulaba, organizatë e studentëve në Karaçi, më 10 dhjetor të vitit 1963, Mewlana Mewdudiu pat deklaruar:

“Zhvillimi tepër i ngadalshëm i të gjitha vendeve muslimane tregon faktin se me sa vështirësi është paguar konflikti i përhershëm i popullit me pushtetmbajtësit, të cilët kanë tentuar t’ia imponojnë popullit vlerat e të huajve. Asnjë prej vendeve muslimane nuk ka qenë në gjendje që në çdo fushëveprim të arrijë ndonjë përparim. P.sh. Turqia ishte një shtet sovran që nga viti 1924, por a mund të lavdërohet se ka bërë ndonjë përparim në industri, prodhimtari etj.? Gjatë periudhës së njëjtë, Japonia dhe Kina realizuan përparim të dukshëm, praktikisht në të gjitha fushëveprimet, dhe ato tani zënë vend ndër shtetet më të zhvilluara të botës. Është i qartë shkakua për ngecjen në përparimin e Turqisë kur dihet për faktin e konflikteve të brendshme, të cilat i imponoheshin popullit nga ana e pushtetmbajtësve sekularistë. Në këtë mënyrë, për ta imponuar civilizimin perëndimor në vend, përhapeshin nga ana e pushtetit idetë e tilla, megjithëse populli dëshironte të ketë një rend shoqëror islamik. Praktika të tilla përsëriteshin pak a shumë në çdo vend musliman. Një komb mund të zhvillohet dhe të përparojë vetëm në kushtet kur ekziston një harmoni ndërmjet aspiratave të popullit dhe politikës së pushtetit. Luftërat aktuale zhvillohen në të gjitha vendet muslimane duke u mbështetur në faktin se populli në ato vende nuk është përgatitur për t’u bashkuar me sunduesit dhe me drejtimin që atij ia imponon pushteti; njëkohësisht edhe pushtetet nga ana e tyre nuk kanë qenë të përgatitura ta udhëheqin popullin në

atë drejtim ku ai dëshiron të shkojë. Këto kanë qenë shkaqet për paraqitjen e konflikteve të përhershme në të gjitha vendet muslimane të botës. Ja pra, ky është “Islami aktual”.¹⁷

Mawlana Mewdudiu dhe lëvizja e tij paraqesin një pendë pa kompromis kundër sulmeve të rajonalizmit, nacionalizmit, sekularizmit, ateizmit dhe materializmit. Ai është armik më i pathyeshëm kundër çdo tentimi të modernistëve që duan ta ndërrojnë Sheriatin (sidomos ligjet që i takojnë statusit personal të njeriut dhe familjes), të na detyrojnë që të bëhemi pjesë e komformitetit të sistemeve moderne ligjore të Perëndimit.

Ai gjithashtu ishte kundërshtar i flaktë ndaj politikës nacionale dhe asaj ndërkombëtare që kishin të bëjnë me kontrollimin e rritjes së numrit të popullsisë me anë të mjeteve kontraceptive, aborteve dhe sterilizimeve, si faktorë diametralisht të kundërt me frymën e doktrinës islamike. Më 1962 publikoi një artikull me titull “Islami dhe kontrollimi i lindjeve”, ku demonstroi duke vënë në dije për një gjendje të pamohueshme për pasojat katastrofike kur përdoren metodat artificiale për redukimin e popullsisë, nisur nga pasojat individuale, shoqërore, kombëtare, ndërkombëtare, deri tek ato ekonomike dhe morale. Ky punim u ndalua posa u publikua, me anë të një urdhri zyrtar të datës 9 gusht 1966, i cili ishte në fuqi deri më 10 mars 1967, për arsye se autoritetet zyrtare u frikësuan nga mundësia e sabotimit të Programit Kombëtar për Planifikimin e Familjes.

Gjatë tri dekadave Mawlana Mewdudiu zhvilloi një luftë pa kompromis edhe kundër herezive, siç ka qenë mohues i haditheve të lansuara nga Ghulam Ahmed Parvezi, madje kundër Kadianive si Rebwah dhe Lëvizjes së Ahmedive në Lahore, hadithe këto të bazuara sipas thënieve të Mirza

¹⁷ Islam Today (Islami sot), Seyyid Ala Mewdudi, Students Publication Bureau, Karachi, 1968, p.p. 57-58.

Ghulam Ahmedit, i cili për veten pohonte se është “Mahdi” dhe “Profet”. I sulmonte pa pra Kadianitë dhe herezinë e tyre në libërthrin “Mbarimi i Profecisë”, publikuar në vitin 1965, ku po ashtu mori ngojë çështjen e Dexhxhalit ose të Antikrishtit, ku ky i dyti vie pas Jezu Krishtit (paqja qoftë mbi Të), Imam Mehdiun, dhe sheshoi planet ekspansioniste të Izraelit dhe konspirimin cionist kundër Botës Islame.

Po ashtu, Mawlana Mewdudiu disa herë qe thirrur në Angli dhe Gjermani nga ana e Shoqatës së Studentëve Muslimanë për t’u bërë një vizitë, t’u mbajë ligjërata dhe t’i këshillojë, por atëherë pushteti pakistanez, i frikësuar nga ndikimi i madh që ky e gëzonte në masat e popullsisë, si një personalitet me famë ndërkombëtare, nuk e përfilli kërkesën e tij për të udhëtuar jashtë vendit. Megjithatë, në gusht të vitit 1968, një trup mjekësor formalisht bëri një ekzaminim të shëndetit të tij, dhe konstatoi se ky gjatë kohë vuan nga gurthët që ka në veshkë dhe nga gjaku, gjë që ka bërë t’i acarohet shumë gjendja shëndetësore, andaj duhej t’i shtrohej një operacioni, i cili mund të bëhej vetëm në Londër. Gjithashtu, për këtë operacion të dyfishtë udhëtimi ishte i vështirë për arsye të shëndetit të lig që kishte, për çka kërkohej të largohet nga vendi edhe për arsye se shumë muslimanë dhe jomuslimanë janë e vizitonin dhe e bezdisnin përditë. Pikërisht, më 15 dhjetor për të u përgatit një pritje madhështore në hotelin “Hilton” të Londrës ku ishin të pranishëm jo vetëm përfaqësuesit e komunitetit pakistanez në Londër, por edhe diplomatë nga shumë vende islamike, përfaqësues të revistave, reporterë dhe gazetarë që shkruanin në gjuhën angleze dhe urdu e po ashtu ishin të pranishëm edhe shumë specialistë dhe orientalistë anglezë. Këtu Mewdudiu fjalimin e tij ia kushtoi sidomos emigrantëve pakistanezë në Britaninë e Madhe. U drejtohej dëgjuesve duke e theksuar atë se nëse muslimanët në Britani kanë për qëllim kryesor të jetojnë konform idealeve dhe vlerave të Islamit, vetë numri i madh i tyre dhe ekspansionizmi

mund të konsiderohen në Perëndim si një akt shumë i pamatur. Por, në rast se ata e lejojnë veten të përkulen nga kompleksi i inferioritetit, vetë imitimi i stilit të jetës perëndimore do të rezultojë si formë e mungesës së identitetit dhe si fundosje totale në kulturën e huaj. Udhëheqësve të komunitetit pakistanez në Londër ua tërhoqi vërejtjen se fëmijëve muslimanë këtu u mungon mundësia për të mësuar për edukatën islame në shtëpi, shkolla, kështu që gjenerata e re për shoqërinë islame mund të jetë e humbur. Insistonte në atë se është gabim për anglezët që të insistojnë në asimilimin dhe absorbimin e muslimanëve në civilizimin perëndimor me sllogan të “integritimit”. Shoqëria multiracore dhe multikulturore për Britaninë e Madhe nuk mund të jetë shkas që të bëhet një forcë e çintegritimit, përkundrazi, me eliminimin e padrejtësisë dhe mosmarrëveshjeve të brendshme, ajo do ta pasuronte jetën kulturore të këtij vendi.

Gjatë vitit të përmendur, në një intervistë që bëri Mewdudiu për disa kompani televizive italiane dhe gjermane, theksoi se gabimi më i madh i njeriut modern përqëndrohet në faktin e pranimit të verbët të gënjeshtërsë se gjoja përparimi i shkencës do t'i mundësojë njeriut shfrytëzimin e elementeve fizike, ndaj njeriu nuk ka nevojë ta pranojë udhëheqjen morale dhe shpirtërore nga Librat e Shenjtë dhe nga revelatat e të dërguarve. Rezultat i këtij mendimi është se jeta perëndimore vetë nuk e njeh paqen. Jeta për Perëndimin është e pakuptimtë dhe pa qëllim, familja në të është shkatërruar, krimet dhe violencat e paevitueshme çdo herë kërcënojnë ardhmërinë e botës. Gabimi i dytë fatal është krijimi në kuptim të ngushtë i njeriut perëndimor. Nëse civilizimi perëndimor nuk është në gjendje të gjejë një rrugëdalje nga këto probleme, si p.sh. diskriminimi racor, atëherë populli mund të mësojë prej Islamit se si ky e ka zgjidhur këtë problem me sukses shumë të madh, dhe si ka arritur deri te kuptimi real i vëllazërimit të njerëzve, sepse në Islam nuk merren parasysh racat dhe përkatësia kombëtare. Detyrë e njeriut perëndimor

është që të shikojë se çka gjendet matanë jetës së tij të kufizuar, dhe të mësojë se në ç'mënyrë xhahadi mund ta largojë tmerrin dhe barbarizmin e luftës, se qysh me zbatimin e mësimëve të Islamit mund të ruhet familja dhe të realizohet personalizimi i individit, i cili aktualisht gjendet në gjendje të një sëmundjeje epidemike mentale, kurse shoqëria në një çintegrim total. Trashëgimia e Islamit nuk i takon vetëm asaj strukture që është lindur si muslimane, por gjithë njerëzimit në botë, thekson Mewdudiu.

Në shtator të vitit 1969 u mbajt Konferenca e Samitit Islamik në Rabat, nën patronatin e mbretit Hasan të Marokut, ku mori pjesë edhe Mwlana Mewdudiu, i cili po ashtu ishte i pranishëm në Fez, në Xhaminë e Universitetit Kairavin, në Konferencën për Arsimimin, ku u takua me personalitete të shquara si: Alal el Fasi, Abdullah Kunum, ish-gubernator i Theutës, Shejh Ibrahim Nijasin e Senegalit dhe autoren egjiptase dr. Ajsha bint Shati. Në Konferencën e Samitit Mewlana Mewdudiu pat takime të veçanta me delegatin e Al Fatahut, Halid Abdul Hatibin të shoqëruar nga disa anëtarë të Ihvanul Musliminit, të cilët kërkuan nga Mewlana ta përkrahë Lëvizjen për Rezistencën Palestineze dhe të lutet për një sukses eventual të saj.

Me plot bindje Mewlana Mewdudiu sqaroi faktin se Islami dhe Socializmi janë të papajtueshëm në mes veti. Në këtë kuptim, Mewlana Mewdudiu shtroi të dhënat e dokumentit të rëndësishëm, në formë të përgjigjeve në 31 pyetje të bëra nga ana e Shorish Kashmirit, redaktor i revistës javore “Weekly Chatan” të Lahores, të cilin e pat publikuar në numrin special të 14 prillit 1969, gjë e cila shkaktoi një tollovi në popull ngase u blenë të gjitha kopjet brenda tri orëve pas daljes nga shtypi:

“Islami dhe Socializmi në të gjitha fushat janë të kundërt njëri me tjetrin. Themeli i Islamit përqëndrohet në besimin në All-llahun. Ne disponojmë me një fe në kuptimin absolut të

Udhëheqjes së Vërtetë në të gjitha fushat e jetës sonë, të cilën All-llahu ia prezantoi Pejgamberit të Tij (paqja qoftë mbi Të) si të Vërtetë dhe Librin e Tij, në mënyrë që ne si muslimanë jemi të obliguar ta ndjekim rrugën e kësaj udhëheqjeje. Për ne, jeta në këtë botë u nënshtrohet sprovave jetësore, kështu që edhe qëllimi i jetës sonë është që ta fitojmë kënaqësinë e All-llahut dhe të Pejgamberit të Tij. Bazuar në këtë besim, Islami na dhuron një sistem komplet moral dhe mënyrë të përsosur të besimit, kështu që në praktikë, jeta jonë plotësisht i përshtatet besimit tonë themeltar. Krahas kësaj, Islami na siguron ligjet dhe rregullimin kuptimplotë në të cilat përfshihet ekzistimi kompleks, prej jetës familjare dhe vendore, në shkollat, gjyqet, parlamentet, në tregjet dhe në relacionet ndërkombëtare.

Socializmi fillon me kundërthënie të theksuara, me idenë e mohimit të tërësishëm të ekzistencës së Zotit dhe të të dërguarve, duke paraqitur një filozofi të historisë së vet materialiste me të cilën beson se çdo gjë në jetën e njeriut varet nga sistemi ekonomik në të cilin ai jeton, duke e mohuar konceptin e vdekjes absolute transcendentale. Me ngadhënjimin e socializmit, ku qëllimi i arsytetimit, mund të përdoren gënjeshttrat, të mposhten premtimet dhe mund të përdoren violenca dhe gjakderdhja. Sistemi shoqëror ISLAM thekson rëndësinë e lirisë së njeriut, duke e ruajtur nga degjenerimi i mundshëm. Kapacitetet individuale kanë mundësi të vijnë në shprehje dhe të zhvillohen; ku në vend të konflikteve dhe kundërshtimeve ndërmjet klasave të cilat i kultivon doktrina komuniste, brenda sistemit ISLAM mund të ekzistojë një bashkëpunim, simpati e ndërsjellë, një sistem i tërësishëm shoqëror, i cili mund ta mposhtë të keqen dhe shtrembërimet nga ana e presioneve që dikush i ushtron, dhe duke i inkurajuar punët e mira të inicuar nga ndonjë palë. Sipas doktrinës marksiste, tentimi për shfrytëzimin e pronës private dhe lirive të njeriut, paraqet themelin e gabimeve. Pra, ai parashtron një sistem të tillë ku të gjitha mjetet e

prodhimit duhet të jenë pjesë e pronës shoqërore, kurse ato individuale, janë të mbërthyera në makinerinë kolektive. Por, ky drejtim paraqet një rrugë të pakuptimtë dhe kontradiktore ndaj mendimit të shëndoshë, ku një ideologjie të cilës i besohet, në individë nuk mund ta mbështesë vetë sistemi besimin, ku njerëzit duke e përbërë makinerinë kolektive të dirigjuar prej qendrës, duhet të bëhen engjëj të pafajshëm dhe nuk do të kenë gabime udhëheqësit ndaj masave të gjera popullore, të cilat gjenden nën kontrollin dhe administrimin e tyre, ku në ekonominë e një vendi të tërë “duhet të përdoren në mënyrë të përsosur pasuritë shoqërore” dhe prej saj “të bëhet një shpërndarje e drejtë.” Filozofia komuniste fillon me konceptin e anësimit, i cili do të thotë “mbështetje proletariatit”, me urrejtje ekstreme dhe dëshirë të flaktë për luftë kundër të gjithë individëve dhe grupacioneve të tjera shoqërore.

Në një sistem të tillë, si është e mundur që njeriu të përjetojë një shpërndarje të drejtë të të mirave për tërë shoqërinë? Nëse dëshironi, këtë e gjeni në praktikën e komunizmit, ku vetëm një grup njerëzish ose grupacione të tyre, mbajnë gjithë fuqinë e distribuimit të pasurisë, dhe se ky koncentrim i kapitalit është edhe më total se sa ta kishte pasë ndonjë mbret në suazat e monarkisë, ose ndonjë kapitalist, respektivisht sundues feudal në shoqërinë kapitaliste ose feudale. Partia komuniste përpos pushtetit mban edhe kontrollin e përgjithshëm mbi të gjitha mjetet e prodhimit. Lidhur me këtë, edhe furnizimi i popullsisë me artikuj të ndryshëm për nevoja të saj nuk ndryshon shumë nga ai i përgjegjësve të burgjeve, të cilët mbajnë fatin e të burgosurve për t’i furnizuar me bukë, veshje, strehim dhe me trajtime mjekësore”.

Sipas mësimave të ISLAMIT, çdo person që fiton në mënyrë legale, atë e ka si dhuratë nga Allahu, e cila si dhunti, nuk kufizohet. Pasuria ilegale, sado e vogël, është ilegale, kurse pasuria e fituar në mënyrë legale, sado e madhe që të jetë, mbetet legale. Në vend të konfiskimit të pasurisë

private nga ana e shtetit, duhet të praktikohet shërimi i “sëmundjeve të vogla” me zhdukjen e “atyre të mëdha”, gjë e cila duhet të jetë cak i ndalimit me ligj i të gjitha metodave të pandershme dhe ilegale, të cilat shpiejnë në drejtim të koncentrimit të padrejtë të pasurisë shoqërore, në mënyrë që për të gjithë banorët duhet të sigurohen nevojat për ushqim, veshje, strehim, arsimim dhe mundësia për shërim mjekësor.

Burim i konfuzioneve të tashme ideologjike në Pakistan është socializmi, i cili me pranimin e filozofisë materialiste, i kundërvihet në mënyrë diametrale ISLAMIT në çdo sferë, dhe me qëllim të mashtrimit të popullit, merret kinse me hartimin e programeve të afërta për shijen e popullit, orvatet t’i bindë injorantët dhe mendjelehtët se këto gjëra joislame, janë islame! Termi “Socializëm Islamik” do të thotë se ky drejtim paraqet një nga shumë drejtimet e mendimeve, të cilat në anët tjera të botës, paraqesin një formë të re të “Islamit”, të cilit i janë mbathë disa doktrina marksiste si kompensim për mangësitë e njohura dhe joadekuate të ISLAMIT. Tani pyesim, pse ata kanë besim në një fe të cilën e konsiderojnë si defekte? Termi “Socializmi Islam” është një ofendim për ISLAMIN dhe për qëndrimet e përgjithshme të tij, kështu që e gjithë kjo nuk është gjë tjetër pos një kundërthënie komplete terminologjike.

Në një intervistë me korrespondentin e një reviste arabe mujore “El Ihvan ul Muslimun” nga Damasku, Mawlana Mewdudiu që pyetur se kush mund t’i kundërvihet komunizmit. Me atë rast ai u përgjigj:

“Ne i kundërvihemi komunizmit jo vetëm se ai në tërësi nuk e pranon sovranitetin e Zotit, vdekjen transcendentale por edhe propagandës militante të ateizmit dhe materializmit, dhe për arsye se rendi i sistemit komunist është pjesë e pandarë e sundimit me dhunë, brutalitetit,

violencës, persekutimit dhe terrorit, kurse për ta zgjatur jetën e komunizmit si sistem, absolutisht është i nevojshëm despotizmi. Po ashtu, ne e kundërshtojmë komunizmin edhe për arsye se ai nuk e toleron lirinë e kritikës, opozitën e qetë, nuk siguron kurrfarë mundësi për reforma ose ndryshime në pushtet me metoda kushtetutare. Sipas pikëpamjeve tona, këta faktorë janë me rëndësi jetike për qëndrimet ndaj fesë. Nëse ju e parafytyroni religjionin në një kuptim të gjerë, atëherë ne gjithashtu e vërtetojmë atë përse e kundërshtojmë komunizmin nga arsyeja e thjeshtë fetare”.

“Ne e kundërshtojmë Bllokun perëndimor dhe politikën e tij imperialiste në masë të njëjtë si komunizmin. Është fare gabim të konsiderohet si e vërtetë se kundërshtimi jonë ndaj komunizmit do të thotë përkrahje imperializmit perëndimor. Nëse dikush në mënyrë simultane u kundërvihet të dy grupacioneve të përmendura, të cilat në mes veti po ashtu janë të kundërta, a thua kjo është një provë e mjaftueshme për vete që patjetër duhet përkrahur njërin bllok ngase ai lufton kundër bllokut tjetër? Të mendohet vetëm në këtë mënyrë nuk është e udhës.”¹⁸

Si rezultat i aktivitetit të Lëvizjes Demokratike të Pakistanit, në fund të shkurtit të vitit 1969, presidenti Ejub Han, më në fund pranoi të mbahet një tryezë e rumbullakët në Ravalpindi me liderët e grupeve kryesore opozitare, dhe ky gjest e gëzoi pa masë tërë vendin, sidomos fakti se presidenti Ejub Han do ta lëshojë postin pas mbajtjes së zgjedhjeve demokratike, të bazuara në të drejtat qytetare, të riformohet sistemi parlamentar, të përfundojë gjendja e jashtëzakonshme e cila u imponua gjatë Luftës Indo-Pakistaneze në shtator të vitit 1965 dhe të anulohet Dekreti për Mbrojtjen e Pakistanit, me anë të të cilit i lejohej Ejub Hanit që rivalët politikë të arrestohen,

¹⁸ M. Mewdudi: “Answers Questions” (Përgjigje, Pyetje,) The Criterion, Karaçi, mars-prill, 1969, f. 36).

arbitrarisht të mbyllen në burg me kohëzgjatje të pacaktuar dhe atë duke mos dalë para gjyqit. Pesë partitë e Lëvizjes Demokratike të Pakistanit kërkuan po ashtu restaurimin e Kushtetutës së vitit 1956, e cila shërbente si bazë themelore për formimin e një shteti islamik para se të hartohej Kushtetuta e vitit 1962 nga ana e Ejub Hanit. Elementet majtiste, sidomos Partia Popullore e udhëhequr nga Dhulfikar Ali Bhutto dhe partitë prokineze si Liga Avami, e udhëhequr nga Mewlana Bhashani, tragjikisht insistonin në veprime me metoda violente dhe refuzonin të bashkëpunojnë në jetësimin e këtij programi. Ata bënë agjitime nëpër vend duke mbajtur fjalime të zjarrta dhe duke u munduar me forca të fundit t'i nxisin masat për një revolucion të tipit komunist. Në këtë kohë shumë studentë ishin në arrest, kurse kolegjet dhe universitetet të mbyllura për gjashtë muaj, nga grevat ishin paralizuar industria dhe tregtia dhe vrasjet, çrregullimet dhe djegiet dërrmonin tërë vendin, sidomos Pakistanin Lindor. Ligjet dhe rendi u prishën në atë masë sa që presidenti Ejub Han dha dorëheqje, kurse në vend të tij erdhi gjenerali Jahja, i cili e mori pushtetin në duar dhe formoi Gjyqin Ushtarak më 25 mars 1969. Gjatë përgatitjeve të zgjedhjeve në vend për restaurimin e demokracisë, Mewlana Mewdudiu skicoi një kod ligjor për etikën politike, teksti i të cilit u lëshua në shtyp, në formën që vijon më poshtë:

1. Askush nuk është i autorizuar ose të shprehet në mënyrë vullgare ndaj ideologjisë në Pakistan, ndaj rendit jetësor islamik demokratik ose solidaritetit të Pakistanit;
2. Asnjë parti, lider ose aktivist përgjegjës nuk guxon ta nënçmojë publikisht nderin e liderëve të partive të tjera. Sidomos kjo s'bën të përhapet gjatë fushatës elektorale, të bëhen falsifikime dhe propagandë përgojimesh ose abuzime gjuhësore kundër partive ose kandidatëve;

3. Çdo parti ka të drejtë për të mbajtur mitingje, procesione dhe demonstrata të qeta, por askush nuk ka fare të drejtë t'i prishë mitingjet dhe aty të ndërhyjë, sikurse në procesione ose në demonstrata të partive të tjera. Në rast të paraqitjes së tyre duhet, bërë një konsultim i shpejtë i ligjit për votime dhe zyrtarisht këto të diskualifikohen;
4. Nuk i lejohet asnjë partie ose individ i propagojë me metoda jodemokratike dhe revolucionare, për t'u bërë ndryshime me forcë ose violencë kundër dëshirës demokratike të popullit. Ndaj, nuk do të kishte të drejtë asnjë parti ose person të organizojë grupe politike duke përdorë këso metoda;
5. Sigurisht, çdo person ose parti ka të drejtë t'i bojkotojë votimet, por nëse ndonjë lider i partisë deklaron se nuk do t'u lejohet edhe të tjerëve ardhja në votime me pengimin që votuesit të mos dalin në vendvotime gjatë kohës së votimeve, kësi soj sjelljesh jo vetëm që i bëjnë të diskualifikohen, por ata duhet të përjashtohen edhe nga jeta politike, duke ditur se këto sjellje dhe veprime janë ofendime flagrante ndaj ligjit dhe vendit;
6. Të gjitha partitë dhe kandidatët, pas shpalljes së kohës së votimeve, duhet të jenë të vetëdijshëm për kohën e abstenimit:
 - a. Mos t'i blejnë votat me para ose me mashtrime;
 - b. Mos t'i sigurojnë votat me anë të presioneve zyrtare ose private, duke u intimiduar me aktivistët e partive dhe përkohësit e tyre,
 - c. Mos të thirren në besëtytni racore, gjuhësore, rajonale ose sektare të votuesve;

7. Çdo parti e cila do të vinte në pushtet do të deklarohej në mënyrë solemne se do të abstenojë nga këto veprime:

a. Ta keqpërdorë makinerinë propaganduesë të shtetit, si: radion, televizionin, informatat e agjencive dhe gazetat në të mirë të saj, dhe kundër partive opozitare;

c. Ta lëshojë rrugën e drejtë, t'i shpërdorë autorizimet ose format e tjera të mbrojtjes së pushtetit me dhënien e ryshfetit anëtarit të ndonjë partie tjetër ose personave të pavarur, në mënyrë që me këto sjellje t'i përfitojë ata në anën e saj;

d. Ta vë kontrollin mbi shtyp dhe mbi platformën e interesit të partisë së tyre;

8. Pjesëmarrja në zgjedhje mos t'i lejohet asnjë partie e cila nuk beson në Islam, në bashkimin dhe solidaritetin në Pakistan, ose atyre që tentojnë të ndërtojnë ndonjë sistem tjetër që është kundër popullit dhe dëshirës së tij për një demokraci të vërtetë.

Gjatë kohës së votimeve në vend, në dhjetor të vitit 1970, Mawlana Mewdudiu me mençurinë e vet kishte paraparë se fitorja e partive rajonale do ta shpie Pakistanin në një shthurje të paevitueshme. Ngjarjet që pasuan pas debaklit, e vërtetuan këtë mendim. Bile as armata nuk që në gjendje ta evitojë revoltën e secesionistëve në Pakistanin Lindor, të cilët kërkonin kokat e mijëra njerëzve jobengalezë dhe të atyre që e përkrahnin Pakistanin e bashkuar, kështu që nuk ekzistonte asnjë mundësi të luftohej ndikimi i marksistëve dhe i indusëve i cili shtohet me parullën BENGALLA DESH, gjë e cila në fund u sendërtua me anën e ushtarëve të Indisë, kur në dhjetor të vitit 1971 ky vend u okupua me përkrahjen e haptë të Britanisë dhe Ruisë, kështu që Pakistani Lindor u nda nga krahu Perëndimor.

Më 24 tetor, 1970, Mawlana Mewdudiu dha këtë deklaratë në fjalimin e hapët që mbajti në Sant Nagar, Lahore:¹⁹

“Më duhet të jem i brengosur për gjithë popullin, i cili u gjet në këtë situatë pasigurie, kur as me forcat e armatosura nuk jemi në gjendje së bashku t’i mbrojmë të drejtat për ta shpëtuar atdheun. Përkritazi me këtë fakt, edhe secili që do të ishte në gjendje të ofrojë ndonjë sugjerim, mund të kuptojë se është shumë larg mundësia e realizimit të idesë për ta detyruar Pakistanin Lindor që të mbetet i bashkuar me Pakistanin Perëndimor, pikërisht tani kur lëvizjet separatiste vazhdojnë të rriten në një masë të madhe. Andaj, për ta themeluar Pakistanin me forcë, asnjë armatë nuk do të ishte në gjendje këtë ta realizojë po të mos ishte faktori i lidhjeve vëllazërore islamike dhe ndjenjat e trashëgimisë së përbashkët islame në të dy anët e Pakistanit, lidhje këto që janë të gjalla edhe në Pakistanin Lindor, sidomos në pjesën dërrmuese të popullit i cili e mbështetë këtë unitet. Ata që mendojnë t’i këpusin këto lidhje, a thua do të kishin sukses sikur forcat e armatosura pakistaneze të ishin në gjendje t’i dalin në ndihmë popullit? Tendencat pirate edhe pse janë në rritje e sipër, nuk do të ishin në gjendje ta rrëmbejnë pushtetin me forcë, po të ishin në pajtim forcat e armatosura pakistaneze me vetë popullin.”

“Gjithashtu, Lëvizja për Pakistanin ka qenë e angazhuar në emër të Islamit, sepse qëllimi kryesor i muslimanëve ishte krijimi i një shteti islamik, dhe në këtë kuptim, pos XHEMAAT-e-ISLAMIT, i cili në detaje e pat shpjeguar programin e vet për krijimin e një shteti islamik, dhe si ky duhet të funksionojë, jemi në dijeni se nuk ka patur tjetër parti. Si e vetmja në këtë fushë, partia e XHEMAAT-e-ISLAMIT ka qenë në mjegullojë t’i thyej ëndrrat e atyre të cilët parafytyronin që

¹⁹ Quoted from Pakistan Times (Cituar në “Pakistan Times), Lahore, 15 qershor, 1969, faqja 3.

Pakistanin ta bëjnë shtet sekular. Si hap i parë për këtë ishin arritjet e Pakistanit në tërësi. Në periudhën e copëtimit, çdokush kishte të drejtë të mendojë se çka do të thoshte fakti sikur diku të ishte SHEJHUL ISLAMI, DAR ul UFTAJA, DAR ul KADHAJA dhe MINISTRIA E VAKFIT, në mënyrë që këto të vepronin së bashku. Lidhjet legale profesionale dhe të gjitha të tjerat në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, nuk ishin në gjendje të bëjnë kurrfarë përgatitje për ta pranuar pëlqimin se vetëm ky do të ishte një propozim praktik për themelimin e një shteti modern islamik, ku pos gjërave tjera, do të kërkohej edhe prerja e dorës së një hajni. Kur dikush kërkonte të zhvillohej ndonjë diskutim rreth Kur'anit, si burim i vetëm i ligjeve, krijohej një amull; ata sipas qejfit të vet i interpretonin problemet e krijuara dhe kështu përgatitej një formë e re e interpretimit të Islamit. Bile, një numër i madh personash intelektualë habiteshin kur dikush e afirmonte faktin se Islami ka sistemin e vet ligjor ose sistemin e vet ekonomik, me anë të të cilëve mund të zgjidhen problemet e njeriut bashkëkohës. Shumë liderë politikë ndiheshin shumë të turpëruar nga mendimet për themelimin e një shteti fetar në shekullin XX. E vetmja ishte Partia XHEMA'AT-e-ISLAMI, e cila për 23 vjet kishte aftësi t'i fshijë një nga një të gjitha dyshimet që ua ngacmonin trurin intelektualëve të lartë. Me këtë u kuptua realiteti i faktit se një shtet nuk mund të quhet islamik përderisa ligjet, gjyqet, policia, forcat e mbrojtjes, të ardhurat dhe sistemi financiar, tregtia dhe industria, me një fjalë, derisa të gjitha fushat e veprimet të shtetit nuk rregullohen sipas parimeve islame. Në veprat dhe shkrimet e Xhema'atit janë përfshirë të gjitha segmentet e jetës së kombit dhe janë dhënë shpjegime, me argumente bindëse, se si ne mund ta përtërijmë jetën tonë në frymën islame, mënyrat e zbatimit të tyre në rrethanat e jetës moderne, dhe si mund të realizohet një ofertë për udhëheqje të përgjithshme. Xhema'ati, me anë të shkrimeve dhe veprave vinte në pah gjithashtu civilizimin dhe kulturën perëndimore, filozofinë e saj të jetës, kapitalizmin dhe komunizmin, duke i vënë nën thjerrë të analizave të gjitha detajet

për beneficionet që i gëzonte klasa e intelektualëve, për dobësitë e saj, të metat dhe për pasojat e zhgënjimit, të cilat këta i përcjellin ngase me to janë mishëruar. Si rezultat i këtij aktiviteti, një pjesë e madhe e intelektualëve dhe e atyre që kanë qenë në shërbimet e pushtetit, të profesioneve të lira, të institucioneve edukative, ose në çdo fushë tjetër të jetës, janë bindur se Islami për këto çështje është superior ndaj të gjitha ideologjive. Në Pakistanin Perëndimor, në kolegje dhe universitete, shumë studentë ishin të gatshëm ta fllojnë jetën për përtëritjen e rendit islam. A ka ngjarë deri atëherë që dikush ose ndonjë parti të ketë mundur ta përgatitë terrenin në Pakistan për themelimin e Islamit? A ka qenë në gjendje dikush të parafytyrojë se çfarë situatë do të krijohet po të mos ishte munda i bërë për këtë kauzë me një aktivitet prej dy dekadash? Xhema'at-e-Islami nuk ka rënë në grackën e vetëlavdërimit, por për atë që kam thënë është një e vërtetë e pamohueshme dhe pa ekzagjerime. Koncepti i pastër për një sistem islamik, aktualisht shumë i përhapur, është i gjallë në mjedisin e inteligjencies, për të cilin edhe ulemaja ka shprehur habi, sidomos kur është fjala për efektet e shkrimeve tashmë e 30 vjet, nga ana e ndonjë grupi. Argumentet e shtruar tani janë përdorur kundër sekularizmit, socializmit ose kapitalizmit, dhe këto kanë shërbyer si prova të gjalla për superioritetin e sistemit islam ndaj atyre të përmendurve, dhe këto të gjitha janë përgatitur si literaturë e shkruar vetëm nga ana e autorëve të Xhema'atit, pa marrë pjesë aty asnjë parti tjetër ose ndonjë person. Kundërshtarët tanë këtë fakt në mënyrë të hapur kurrë nuk e kanë pranuar, por në zemrat e tyre këto i përjetonin si fakte të gjalla”. Më 1 prill, 1971, Mawlana Mewdudiu u dërgoi një telegram parive të të gjitha vendeve islamike, me këtë përmbajtje:

“India në mënyrë të hapët është përzier në punët e brendshme të Pakistanit, duke shkaktuar në mënyrë agresive trazira në Pakistanin Lindor. Shteti i vetëm që i ndihmoi kësaj politike është

Izraeli. Kjo tregon për një provë të gjallë të intrigave indo-cioniste që janë duke vepruar në ndarjen e Pakistanit, shtetin më të madh musliman, i cili gjithmonë i ka dhënë përkrahje kauzës islame në çdo vend të botës. Për këtë arsye, i thërras qeveritë dhe ekselencat e juaja, ta merni me seriozitet këtë vërejtje, të tregoni aktivitetet dhe të bëni ndikim të duhur gjithkund kundër këtij sulmi që u bë mbi ne, pa asnjë arsyetim, ku u përdor një violencë e hapët kundër Ligjit ndërkombëtar dhe kundër sjelljeve civilizuese.”

Më 5 qershor 1971, kur gjendja në Pakistanin Lindor u bë kritike, Mawlana Mewdudiu u dërgoi një Memorandum shefave të të gjitha shteteve islamike, organizatave muslimane, atyre britanike dhe të SHBA-ve dhe gjithë shtypit pakistanez, me këtë përmbajtje:

1. Para së gjithash, duhet të jetë e qartë se populli i Pakistanit Lindor kurrë nuk ka kërkuar të ndahet. Asnjë prej muslimanëve nuk ka votuar për Shejhun Muxhibur-Rrahman që ta kryejë aktin e separatizmit, po ashtu asnjë musliman prej këtyre rajoneve të përbashkëta nuk ka marrë pjesë aktive në rebelimin e filluar më 1 mars, 1971. Faktikisht, kjo lëvizje secesioniste ka filluar të zhvillohet nga ana e një dege të Shoqatës së Veçantë të Nacionalistëve Bengalezë, anëtarët e së cilës janë shkolluar dhe edukuar në koxhet dhe universitetet ku kanë ligjëruar profesorët indusë, por jo të shkolluar në frymën islame. Dega e përmendur e shoqatës në fjalë është frymëzuar nga literatura bengaleze, e shkruar nga autorët indusë. Anëtarët e saj Islamit e kanë zëvendësuar me ateizëm dhe me moral të shëmtuar, gjë që ka arritur një shkallë të gjerë. Kjo degë e popullatës muslimane ka qenë e përkrahur nga indusët e Bengalit, numri i anëtarëve të së cilës arrinte rreth 8-10 mil. veta (rezultatet e regjistrimit të ri të popullsisë ende nuk janë të njohura, prandaj numri i të pranishëmve në këto rebelime mund të jetë i gabueshëm). Këta indusë, nacionalistë bengalezë dhe socialistë, të gjithë muslimanët jobengalezë i quanin armiq ngase ata kishin ardhur nga

Pakistani Perëndimor, ose si emigrantë nga India që kishin ardhur pas ndarjes së nënkontinentit të Indisë, dhe këto bëheshin thjesht për shkak se kjo strukturë e popullsisë nuk ishte bengaleze dhe e përdorte gjuhën urdu, ashtu që kjo fushatë e urrejtjes kundër tyre ishte bërë fushatë e ndjekjes së tyre prej Pakistanit Lindor. Përndryshe, kjo fushatë pat filluar disa vjet pas themelimit të Pakistanit, duke vazhduar edhe gjatë periudhës së besëtytnisë nacionaliste në Bengal, ku në shënjestër për gjakderdhje, djegie dhe dhunime ishin vetë ata, jobengalezët. Sukseset e arritura të këtij grupi gjatë periudhës së votimeve të fundit krijojnë një pasqyrë të rrejshme në opinion, duke i paraqitur masat e muslimanëve në Pakistanin Lindor gjoja se ishin me ta. Që t'ua ilustroj këtë më mirë, në faqet e ardhshme do ta shpjegoj shkakun e këtij “suksesi”.

2. Në ditët e fundit të regjimit të Ejub Hanit u hetua në mënyrë të qartë se India, sikurse edhe Amerika dhe Britania e Madhe, ishin të ngarkuara me krijimin e situatës se si duhet copëtuar Pakistanin. Indusët e Indisë së bashku me hebrenjtë, përhapnin urrejtjen dhe armiqësinë në masa ndaj Islamit dhe muslimanëve, në mënyrë që ekzistenca e Pakistanit për ta paraqiste një anatëmë. Gjithashtu, në Amerikë ishte mirë i njohur fakti se aty cionistët kishin mbështetje të madhe për ta zhvilluar politikën armiqësore ndaj Pakistanit, me “arsyetimin” se pakistanezët i përkrahnin me entuziazëm arabët kundër Izraelit, qysh prej fillimit të luftës. Me të vërtetë, përkrahja e madhe që iu dha arabëve nga ana e Pakistanit, nuk u dha nga asnjë vend tjetër musliman joarab. Për këtë arsye, cionizmi ndërkombëtar i angazhoi të gjitha forcat e veta kundër Pakistanit. Në këtë kuptim, është fare mirë i njohur fakti se Britania e Madhe ka ushqyer qysh herët urrejtje të thellë kundër Islamit dhe muslimanëve në botë. Ajo vetë e ka pranuar krijimin e Pakistanit sepse ka qenë e detyruar ta bëjë atë, por duke e lënë sherrin e madh me problemin e Kashmirit, dhe vetë ajo është

përgjegjëse për këtë ngjarje. Fundja, qëndrimi i Britanisë kurrë nuk ka qenë i shprehur në të mirë të Pakistanit, qysh prej krijimit të shtetit.

3. Kur i erdhi fundi regjimit të Ejub Hanit, filloi periudha e gjeneral Jahja Hanit, periudhë kjo në të cilën u zgjuan elementet konspirative majtiste, të cilat ishin aktive në çintegrimin e Pakistanit. Këto elemente turbulluese tentuan me të gjitha fuqitë ta shkatërrojnë vendin, duke shkaktuar përçarje mes grupeve, me qëllim të krijimit dhe përhapjes së ideve destruktive nacionaliste, të bazuara në ndarjen territoriale dhe gjuhësore të Pakistanit. Qëllimi kryesor i aktivitetit të tyre ishte i përqëndruar në Pakistanin Lindor. Rusia me gjithë zemër vazhdonte përkrahjen e këtyre elementeve të huaja të cilat përbëheshin nga indusët, cionistët dhe vetë Amerika, i ndihmonte shumë me mjete dy partitë e përbëra kryekëput nga nacionalistët rajonalistë. Njëra ishte partia e Muxhibur-Rrahmanit pa ndonjë ndikim në Pakistanin Perëndimor, dhe e dyta, e Dhulfikar Ali Bhutos, e cila nuk kishte ithtarë në Pakistanin Lindor. Armiqtë tanë e kishin të qartë se nëse këto dy parti dalin ngadhënjimtare, Pakistani automatikisht duhej të ndahet në dy pjesë. Siç u përmend më parë, në Pakistanin Lindor jetonin rreth 8-10 mil. indusë, dhe vetëm ata e mbështetnin politikën e Muxhibur-Rrahmanit. Në zgjedhjet që u bënë në të dy rajonet u realizua mbështetja këtyre dy partive, të cilat ushtruan ndikim të madh në masat zgjedhore, dhe situata kështu mori fund. Me rëndësi është që ta cekim faktin se edhe nëse një kandidat indus do t'i kontestonte zgjedhjet vendore, indusët e tjerë kërkonin që votat t'i jepen kandidatit të Shejh Muxhibur-Rrahmanit, duke mos e pranuar bashkërajonalistin e tyre.

Në Pakistanin Perëndimor, Kadianitë (këta e pranojnë Mirza Ghulam Ahmedin nga vendi Kadian në Indi, në cilësi të profetit), ushtronin ndikim të madh në pushtet dhe dispononin me mjete të mëdha financiare, duke i dhënë mbështetje të madhe Dh. A. Bhutos. Së pari, Kadianitë e

Pakistanit Perëndimor mendonin se një shtet islamik është shumë i dëmshëm për interesat e tyre, kurse një shtet antiislamik, edhe sikur të jetë komunist, për ta do të ishte i pranueshëm. Së dyti, meqë në Pakistanin Lindor këta nuk kishin kurrfarë përkrahje, e gjithë fuqia e tyre ishte përqëndruar në Pakistanin Perëndimor, por edhe dëshira e madhe dhe përpjekjet që i bënë ishin përqëndruar në Pakistanin Lindor, që të bashkuar me komplotistët ta ndajnë Pakistanin Lindor prej atij Perëndimor, në mënyrë që më vonë të kenë fuqi dhe aftësi që ta vënë nën sundimin e tyre Pakistanin Perëndimor dhe kështu të krijojnë një “shtet kadianit” në bashkëpunim me Z. Bhuton.

5. Gjatë fushatës elektorale, prej fillimit e deri në kohën e votimeve, partia e Muxhibur-Rahmanit në Pakistanin Lindor, bashkë me partinë e Z. Bhutos në Pakistanin Perëndimor, vazhdimisht bënë zullum dhe huliganizëm mbi popull, me qëllim që bindshëm t’i fitojnë votimet. Këto u arritën me anë të burimeve dhe ndihmave enorme financiare, me ushtrimin e huliganizmit dhe violencave të ndihmuara nga vetë zyrtarët në pushtet, të cilat sidomos ishin të hapta në Pakistanin Lindor, kështu që rezultatet e votimeve u arritën ashtu si dëshiruan armiqtë e Pakistanit, në Pakistanin Lindor fitoi një parti rajonale dhe në atë Perëndimor, partia tjetër rajonale, fitore kjo bindëse, me shumicë të votave.

Shkurtimisht do t’i përmend ngjarjet politike të cilat u zhvilluan pas votimeve:

Shejh Muxhibur-Rahmani filloi t’i cekë vazhdimisht gjashtë pikat e tij, të cilat në të vërtetë ishin program për separatizëm. Nëse hedhim një shikim në gjashtë pikat e tij, mjaft qartë duket se ato ishin plan për ndarjen e Pakistanit në disa shtete të pavarura. Shejh Muxhibi dy herë u betua në dy tubime të ndryshme, para anëtarëve të zgjedhur të kësaj partie, por, prej të cilëve kërkoi se nuk

duhet lëshuar pe në asnjë mënyrë kur është fjala për gjashtë pikat e tij, të cilat janë pika kyç të programit partiak të tij. Lidhur me këtë, Shejhu e këshilloi popullin se nëse devijohet nga rruga e këtyre gjashtë pikave, “ai për së gjalli do të varroset”.

Z. A. Bhuto bëri përpjekje për t’u marrë vesh me Shejh Muxhibur-Rahmanin për ndarjen e pushtetit me të, por ata në një pikë nuk ranë dakord. Shejh Muxhibur-Rahmani insistonte se duhet doemos të thirret Mbledhja e Asamblesë, në mënyrë, dhe tentim, se me këtë bëhet një përputhje me kornizën e Kushtetutës, nëse hyjnë të gjashtë pikat e tij, të cilat me anë të magjorancës do të votoheshin në Asamble. Në anën tjetër, Z. A. Bhuto u përpoq shumë për ta penguar Mbledhjen e Asamblesë, para se të bëhej ndarja e pushtetit ndërmjet tyre.

Gjatë kohës së këtij konflikti, mbledhja e Asamblesë u caktua për 3 mars. Por, Z. Bhuto deklaroi më 28 shkurt në Lahore, në një miting të tij, se në rast se një anëtar i zgjedhur i partisë së tij shkon në Dakë të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë, “do t’ia thyejmë këmbën” dhe “në qoftë se anëtarët e partive të tjera duan të shkojnë, atyre nuk do t’ua paguajmë biletat kthyesë”. Në këto rrethana, presidenti, gjenerali A. M. Jahja Hani, e shtyu mbledhjen e Asamblesë.

Lajmi për shtyrjen e Asamblesë u kumtua më 1 mars, gjë e cila u përcoll me rebelime të paevitueshme në Pakistanin Lindor. Si rezultat i kësaj kryengritjeje Shejh Muxhibi dhe partia e tij praktikisht e morën në duar administrimin civil të këtij rajoni. Me urdhrin e tyre u suprimuan gjyqet. Administrata e pushtetit po ashtu u suprimua. Nëpunësit e policisë dhe pushteti bengalez kaluan në anën e tyre. Flamuri i Pakistanit u dogj. Himni kombëtar u zëvendësua me një vjershë të Tagores, poetit indus (kjo vjershë u shkrua më 1905 nga R. Tagore me qëllim që mos të ndahet Bengali Lindor nga ai Perëndimor, ku përkrahet uniteti i Bengalit. Ishte fare e qartë përse kjo

vjershë u pranua për himb kombëtar të Pakistanit Lindor, sepse u pa që partia e Shejh Muxhibit me të vërtetë ishte zhytur në mentalitetin indus). Tani Pakistanin Lindor e mëruan Bengalla Desh, kurse flamuri i pavarësisë së Bangladeshit menjëherë u ngrit. Dyqanet e muslimanëve jobengalezë u plaçkitën dhe u shkatërruan. U sulmuan pronat dhe nderi i mijëra muslimanëve të tillë. Gratë u poshtëruan dhe u dhunuan, kurse fëmijët vriteshin para syve të prindërve të tyre. Incidentet me djegien e njerëzve për së gjalli morën përmasa të mëdha. Të gjitha këto krime u ekzekutuan mbi muslimanët e pambrojtur, atyre që nuk i takonin popullatës bengaleze dhe të cilët flitnin gjuhën urdu ne vend të bengalishtes. Të gjitha këto krime, ashtu siç ceka më lart, nuk ishin të drejtuara vetëm kundër muslimanëve të Pakistanit Perëndimor, por edhe kundër miliona muslimanëve të tjerë, të cilët ishin banorë të Pakistanit Lindor, të ardhur nga India gjatë kohës së ndarjes së shtetit indus nga Pakistani. Ata nuk patën tjetër atdhe pos këtij vendi. Ishin ironi e madhe skenat ku nacionalistët dhe socialistët bengalezë me prejardhje muslimane, i ndihmonin indusët kur bënin masakra masive mbi muslimanët jobengalezë, kur i dhunonin dhe poshtëronin gratë e tyre, dhe kur ua plaçkitnin pronat. Në histori rastet e tilla janë shënuar si të rralla, skena të tmerreve që dëshmojnë se muslimanët i kanë masakruar vëllezërit e tyre muslimanë, duke bashkëpunuar me armiqtë e fesë së tyre, si dhe skena të dhunimit të grave muslimane. Por, këto krime, më parë janë planifikuar nga nacionalistët dhe socialistët bengalezë, emrat e të cilëve, mjerisht, ishin muslimanë. Do t'i kisha pyetur ata të cilëve në zemër u fle Islami, a thua këta muslimanë mund të trajtohen si muslimanë, dhe si aq shumë “muslimanë” duhet të dënohen për shkak se e kanë njollosur emrin e hyjnueshëm Islam duke i ndihmuar kriminelët dhe armiqtë e tyre, dhe lidhur me këtë, kush mund ta arsyetojë faktin që për muslimanët e vvarë kurrkush nuk e ngriti zërin e protestës?

7. Presidenti, gjenerali A. M. Jahja Han, bëri atë që mundi ta bëjë prej 15-25 maj, për të arritur një marrëveshje me Shejh Muxhibur-Rrahmanin, dhe si rezultat i kësaj do të ishte që Pakistani të shpëtojë nga copëtimi, por, të gjitha këto veprime ishin të kota. Më vonë, gjatë vizitës së presidentit që ia bëri Dakës, aty u pa se forcat e armatosura pakistaneze u ishin nënshtruar poshtërimeve nga ana e bengalezëve dhe ishin mbyllur ngase u ishte ndaluar qarkullimi. Po ashtu edhe furnizimi me ushqim dhe nevojat e tjera u ishin ndërprerë, dhe sa herë që këto forca kalonin nëpër vendbanimet e tyre, u nënshtroheshin maltretimeve të mëdha. Bile, edhe plani për arrestimin e presidentit Jahja Han qysh më parë ishte përgatitur në Dakë.

Në këto rrethana, kur u kuptua mirë se nacionalistët bengalezë ishin të gatshëm që natën, më 25 ose 26 mars, ta shpallin pavarësinë e “Bengalla Deshit”, armata filloi me operacione, por mjerisht, ishte shumë vonë. Me shpalljen e pavarësisë së “Bengalla Deshit”, India vrapoi menjëherë që ta njohë “këtë shtet”. Në anën tjetër, për Shejh Muxhibur-Rrahmanin nuk kishte kurrfarë pengese që të kërkojë ndihmë nga India, dhe si përgjigje, India menjëherë ndërmori dërgimin e një pjese të armatës së vet në Pakistanin Lindor, në mënyrë të njëjtë, ashtu siç kishte vepruar në rastin e Kashmirit.

Kështu ishte gjendja kur armata vendosi të inkuadrohet në aksion, dhe kush mund të thotë se ky akt i saj nuk ishte i arsyeshëm? Për këtë, le të na tregojë ndonjë shtet i cili mund të jetë si spektator i jashtëm, se qysh një pjesë konstitutive e vendit forcat e një shteti të huaj përpiqen ta ndajnë, dhe mos të ndërmarrë asgjë për këtë akt piratesk duke menduar “le të bëhet si të bëhet”. Në shekullin XIX, dy demokraci të mëdha janë ballafaquar me lëvizjen secenioniste, dhe që të dy forcat janë mposhtur me fuqinë e armëve. Më 1847, shtatë shtete romano-katolike të Zvicrës patën deklaruar se do të ndahen nga konfederata zvicerane, por shtetet e tjera që mbetën në

konfederatë, luftuan kundër tyre dhe i detyruan që t'i bashkohen konfederatës. Ngjashëm me këtë, më 1860, shtetet jugore të SHBA-së u deklaruan për ndarje, por pas një lufte të përgjakshme, ato u detyruan përsëri të bashkohen me SHBA-në. Në kohë të fundit, kur filloi lëvizja për ndarjen e Katangës nga Kongoja (Zaire), më 1960, 20.000 ushtarë u dërguan nga ana e Kombeve të Bashkuara për ta shuar kryengritjen. Nigeria aktualisht është shembull i freskët për këto lëvizje. Të gjitha vendet i dhanë të drejtë Nigerisë për përdorimin e armëve me qëllim që t'i përfundojë tentimet e Biafrës për secesionim nga Nigeria. Gjithashtu, i tërë shtypi perëndimor dhe vetë Papa ushtruan ndikim në çështjet lidhur me Biafrën, dhe legalisht asnjë vend nuk pat guxim të thotë se Nigeria duhet në mënyrë të qetë ta tolerojë kryengritjen e armatosur në një pjesë të territorit të saj, dhe se kundër saj nuk duhet të ndërmerret asnjë aksion i armatosur.

Këto shtete u morën si shembuj se si me forcë u thyen planet e secesionistëve për ndarjen e pjesëve integrale të vendit të tyre. Tani vonë, Rusia përdori forcat e veta ushtarake kundër vendeve sovraane të bllokut komunist, dhe i detyroi që të mbeten anëtare të këtij blloku. Pas këtyre ngjarjeve po e shtroj pyetjen se kush është ai që ka mundësi t'u kundërvihet aksioneve të tilla në Pakistan? A ekziston ndonjë vend në botë i cili do të toleronte një revoltë të përcjellur me aksione ushtarake brenda kufijve të vet, dhe t'i pranojë pasojat e copëtimit të vendit? A thua India këtë gjë do ta toleronte? Britania e Madhe a do të pranonte t'i bëhet një gjë e tillë? A do të ishin të gatshme të pranojnë një gjendje të tillë brendapërbrenda kufijve të tyre Amerika, Franca, Rusia ose ndonjë vend tjetër? A është Kanadaja e gatshme ta tolerojë lëvizjen për ndarjen e Kvebekut nga ky vend?"

Më 6 shkurt 1972, Mawlana Mewdudiu u dërgoi telegram Kombeve të Bashkuara, Rabitës së Alemit Islamit në Mekke dhe të gjithë kryetarëve të shteteve islamike të botës, me këtë përmbajtje:

“Në Pakistanin Lindor, miliona muslimanë bengalezë dhe jobengalezë, lojalë Islamit dhe Pakistanit të bashkuar, i janë nënshtruar një terrori brutal nga ana e armatës indiane dhe Mukti Bahinive, të ushtruar për vrasje dhe arrestime masive, me viktime të shumta. Kolonistët civilë të përbërë nga muslimanët jobengalezë po ashtu janë të rrezikuar nga sulmet dhe dhunimet, e në disa raste janë përdorur raketat dhe bombat. Vetëm në Dakë gjysmë milion muslimanë-jobengalezë, janë në gjendje të rrezikut nga shfarosja. Institucionet fetare dhe arsimore janë rrënuar ose janë mbyllur. Ulemaja e muslimanëve bengalezë është vrarë ose është arrestuar. Lutjet kolektive në xhami janë vështirësuar shumë. Fuqitë e mëdha dhe shtetet e tjera, të cilat ishin të interesuara për thëniet e “krimeve të armatës pakistaneze”, tani janë në rol të shikuesve të qetë. Edhe pse tirania e ashtuquajtur Bengalla Desh dhe forcat okupuese të Indisë bënin krime të mëdha, për ta nuk ishte tirani, por, përkundër, “bamirësi” nga e cila nuk ka asgjë të keqe e as nuk krijohen probleme humane. Andaj, ju lutem, përdorni masat e presionit për ta ndalur këtë gjakderdhje dhe këtë krim!”

Më 12 tetor 1972, Mewlana Mewdudiu këtë letër ua dërgoi edhe avokatëve të shquar botërorë, qendrave islamike, institucioneve muslimane, krerëve të lëvizjeve islamike, organizatave të rinisë dhe atyre studentore, kompanive të ndryshme të mjeteve të informacionit dhe redaktorëve të shquar të gazetarisë britanike, kanadeze, amerikane, franceze, aziatike, shteteve arabe, Sekretariatit Islamik, Kombeve të Bashkuara dhe ministrive të punëve të jashtme të vendeve islamike.

Më 16 dhjetor 1971 kur u pushtua Daka, armata pakistaneze dhe nëpunësit civilë nga Pakistani Perëndimor atje të emëruar, tregtarët të cilët gjendeshin në Pakistanin Lindor për ta zhvilluar biznesin dhe familjet e tyre u zunë si robër lufte dhe si të tillë u dërguan në kampet e përqendrimit në Indi. Gati një vit kaloi e India gjeti pretekste të ndryshme që t'i mbajë ata në

gjendje të mjerueshme dhe deri më tani ende nuk është e gatshme që t'i lirojë, por përkundrazi, si për inat, ende i mbanë si pengje. Konventa e Gjenevës në mënyrë të qartë e shpjegon këtë lëndë, kështu që këta njerëz duhet të lirohen pa asnjë shtyerje të kohës, sidomos tani kur lufta mori fund. Përndryshe, këto nuk janë sjellje civilizuese ngase nuk ka ligjshmëri kur mbahen njerëzit si robër luftime, kur dihet që atje kanë qenë të dërguar për ta kryer shërbimin ushtarak, kurse ende mbahen si të burgosur. India u paraqit me pretekst lidhur me këta të burgosur, se armata pakistaneze më parë ka filluar t'i dorëzohet Indisë e pastaj armatës së Bangladeshit. Ky pretekst kurrë nuk mund të pranohet për civilët e zënë si robër luftime, për arsye të thjeshtë, se ata nuk morën pjesë në luftë, dhe si të tillë, kurrkujt nuk ia kanë dorëzuar armët. Sa i takon çështjes së armatës, India thekson se komandanti i armatës pakistaneze ka nënshkruar dokumentin në të cilin thuhet se më parë ajo i është dorëzuar armatës së përbashkët. Por nëse në këtë dokument thuhet se fjala është për persona të zënë në luftë, ky fakt fare është i paqëndrueshëm. Fakti i vërtetë është ky: se në atë kohë nuk ka ekzistuar ende qeveria e Bangladeshit (më 16 dhjetor), kështu që ajo nuk ka disponuar me armatë të rregullt, dhe me këtë shihet qartë se atëherë nuk ka pasur kurrfarë baze themelore për t'u kryer akti i dorëzimit. Dorëzimi i është bërë vetëm armatës së Indisë, por India mundohet ta bindë opinionin se komandanti i ushtrisë pakistaneze i është dorëzuar komandës së përbashkët Indo-Bangladeshe. Aktualisht, nga ana e shtetit të ashtuquajtur Bangladesh bëhen krime edhe më të mëdha ndaj civilëve, me pretekst se këtu bëhet fjalë për luftën kundër kriminelëve, qoftë bengalezë ose jobengalezë, të cilët janë gjetur në Pakistanin Lindor, duke u përkrahur nga pushteti i Pakistanit për ta shpëtuar Pakistanin Lindor. Andaj, pushteti që këta i përkrahte ishte pushtet legal kundër të cilit është zhvilluar lufta për ta shpëtuar vendin e tyre, dhe si të tillë, a ishin tradhtarë të ndihmuar nga armiku i jashtëm, me qëllim që ta pushtojnë vendin? Tani, tradhtarët u bënë sundues dhe i gjykuan si kriminelë luftime të gjithë ata që

ishin në anën e pushtetit legal ligjor. Qeveria e ashtuquajtur e Bangladeshit kërkonte që të gjykohen rreth 1000 oficerë të armatës pakistaneze. Këta u dërguan si robër luftime në Indi, dhe bile, haptas u kuptua se ndërmjet Indisë dhe Bangladeshit u nënshkrua një marrëveshje për t'i kthyer këta në Pakistanin Lindor dhe për t'i gjykuar. Tani shtrohet pyetja, a mos ky rebelim kundër pushtetit legal dhe armatës së vendit u përdor për ta thyer revoltën dhe athua ky hap është një proces legal i rebeluesve, të cilët pas suksesit që patën në shfrenimin e treguar, do ta gjykojnë armatën e vendit e cila ishte besnike ndaj pushtetit legal dhe për këtë arsye i rezistoi revoltës. Kjo do të thotë se edhe nëse në një vend shpërthen lufta civile, për ta thyer revoltën e secesionistëve, përdorimi i forcës do të ishte një gjë jashtëligjore, ose nëse këto forca do të kishin sukses për ta thyer secesionizmin, duhet tani të gjykohen si kriminelë luftime, vetëm e vetëm pse kanë qenë të betuar si armatë për t'i bërë rezistencë revoltës së shprehur kundër një pushteti legjislativ. Një gjë e tillë e shkaktuar kudo në një vend tregon faktin e një luftime civile, dhe përdorimi i forcës për ta thyer revoltën e secesionistëve a duhet të jetë një akt joligjor, dhe se këto subjekte tani duhet gjykuar si kriminelë luftime në rrethana kur revolta është kryer me sukses? Aktualisht, jemi të ballafaquar me këtë situatë, dhe me rëndësi është që ky problem të shtrohet në rend dite para Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara e po ashtu të shtrohet si problem në gjithë shtypin ndërkombëtar. Besojmë se problemi në tërësi do të shpjegohej në tërë botën me anë të shtypit.”

Më 29 tetor 1972, Mawlana Mewdudiu me ashpërsi kritikoi presidentin Bhuto për fjalimin e tij të mbajtur në Lajalpur para dy ditëve, në të cilin insistoi të pranohet “e vërteta” për Bangladeshin.

Presidenti Bhuto insistonte në atë që të pranohet ndarja e Pakistanit Lindor, me aso pikëpamje si fillestar në pushtet i ardhur. Për këtë as që mund ta arsyetojë marrjen mbi vete të kësaj detyre, bile

as në pjesën perëndimore të vendit. Mënyra se si është sjellur ndaj përpjekjeve për t'i sendërtuar objektivat e duhura, vetëm që u tregua si plot kundërthënie në raport me pozitën e tij dhe me atë të vendit. Lojërat e vrazhda diplomatike me popujt e vegjël, por jo edhe me fuqitë e mëdha, pranimi i Bangladeshit si akt i kryer, dhe më vonë rivënia e raporteve me popujt e vegjël, e bënë Pakistanin shumë qesharak para botës. Biseda presidenciale e 14 gushtit në Parlament ishte një kalkulim, vetëm e vetëm që ta shtrembërojë historinë tonë, i cili po ashtu ishte në shpërputhje me pikëpamjet e mëparshme të presidentit. Në vigjilje të udhëtimit të tij për në Simla, sugjeronte opinionin se nuk do të flasë me qeveritarët e Indisë rreth çështjes së Bangladeshit, kurse pas ardhjes nga India dha deklaratë të prerë se përsëri nuk është biseduar në mënyrë sekrete asgjë, përpos asaj që u shkrua në marrëveshje e që ishte e paqëndrueshme me deklaratën e Indisë ku thuhej se presidenti në mënyrë afirmative tha se do ta njohë Bangladeshin. Bhuto pat deklaruar se realiteti i Bangladeshit nuk mund të injorohet për një kohë të gjatë dhe se ne duhet ta njohim atë shtet. Në të njëjtën kohë na siguronte se për këtë gjë më parë populli duhet ta thotë fjalën e vet. Por, cila është rruga për ta siguruar lejimin ose moslejimin e popullit për të gjetur rrugëdalje nga kjo situatë? Presidenti tashmë e kishte konsultuar popullin lidhur me këtë qysh në Lahore para se të udhëtonte për në Simla, ashtu siç bëri me rastin e lejimit që të marrë pjesë Muxhibur-Rrahmani në tubimin publik në Karaçi. Atëherë populli vetë e refuzoi njohjen e Bangladeshit. A thua sa herë populli duhet ta japë mendimin e vet për çështjen e Bengalla Deshit në mitingjet publike? Vërtet, populli pranoi duke i ngritur duart në të mirë për gjetjen e rrugëdaljes, në Pakistanin Perëndimor një mijë herë u deklarua, kështu që a do të ishte i logjikshëm qëndrimi që për fatin e Pakistanit Lindor të vendoset në këtë mënyrë? Ai theksonte se Pakistanin duhet shikuar si një trup të njeriut, i cili qysh prej lindjes së tij është i destinuar të ketë dy krahe. Për hir të argumenteve, të supozojmë se vetë populli i një krahu do të dëshironte t'i amputohet krahu tjetër,

dhe kështu, a ka arsytim për këso llogari? Presidenti Bhuto insistonte ta përcaktojë drejtimin e një mobilizimi të opinionit publik se për të është punë e mirë njohja e Bangladeshit, mirëpo, argumentet për këtë qëndrim të tij janë inicuar qysh në Lajalpur, aq më tepër, ai tentonte që në sjelljet e veta të len përshtypjen se çështja e Bangladeshit është më tepër punë e Indisë se sa që kërkohet të jetë e Pakistanit. Ishte edhe gjë e sigurt se ndarja e Pakistanit Lindor nuk ishte vetëm pasojë e agresionit të Indisë, por ngase populli në Pakistanin Lindor u ngrit në këmbë i armatosur, sidomos i organizuar nga ana e Mukti Bahinive, për ta luftuar armatën e Pakistanit, andaj India për t'i përkrahur këta e dërgoi ushtrinë e vet. Ky akt nuk e arsyeu Indinë se ajo nuk ka qenë shkaktare për agresionin që u bë, por në vepër tregoi shumë dëshirë që ta paraqesë veten se e kishte për “detyrë të shenjtë” t'i përkrahë dashamirët për pavarësinë e Pakistanit Lindor. Ishte ky një tentim i pabindshëm të thuhet se armata pakistaneze qe agresor në këtë rast, me arsye se ajo tentoi pa sukses t'i mbajë me forcë secesionistët në kuadër të Pakistanit. Por, nëse do t'i besohej faktit se popullsia e Pakistanit Lindor vetë kishte kërkuar për t'u ndarë nga Pakistani Perëndimor, nga kjo del si përfundim logjik se prej forcave të armatosura nuk kanë marrë pjesë vetëm disa qindra veta, por i gjithë trupi i tij “ishte agresor”, sepse brenda tij kishte me mijëra patriotë bengalezë, të cilët i përkrahnin forcat e armatosura pakistaneze, dhe tani a duhet edhe ata të persekutohen si tradhtarë! A do të deklaronte ndonjë burrë shteti më keq kundër vendit të vet se ç'bëri ky? A është e arsyeshme të thuhet se i gjithë populli i Pakistanit Lindor ishte për secesion?

Në votimet e vitit 1970, a thua populli votoi për separatizëm? A thua mbledhja e Parlamentit, e mbajtur më 3 mars 1971, u thirr për të gjetur rrugëdalje për secesion? Nuk është e vërtetë se lëvizja për secesionizëm nuk ka bashkëpunuar me dikë nga popullata muslimane, dhe pos kësaj,

Mukti Bahinitë kanë qenë të stërvitur nga armata e Indisë, por përse ata nuk u treguan trima dhe nuk kishin sukses kur ndesheshin me forcat e armatës pakistaneze? Nuk mund të mohohet fakti se po të mos ishte sulmi i indusëve, Pakistani Lindor kurrë nuk do të shkëputej. Mawlana Mewdudiu thotë se këto kanë qenë ngjarje të vërteta, të cilat kurrë nuk mund të injorohen. Por, ishte çështje jofatlume se kryetari i shtetit, duke e cilësuar këtë ngjarje si të vërtetë me një perspektivë të gabueshme, dëshironte së paku, t'ia lajë faqen e zezë vetë Indisë. Disa veta u bënë separatistë falë kuptimit të gabueshëm të tyre, dhe tani ata kërkonin që të ndërpriten marrëdhëniet me Pakistanin. Pas këtyre vështirësive të përjetuara dhe krimeve të papërshkrueshme që bëri India, pajtimi ynë për shkëputje në momentin e pikërishtëm, do të thoshte pajtim me shkatërrimin e frymës së shpresës së vetë popullit.”²⁰

Njëherë e pata pyetur Mawlana Mewdudiu përse Xhema'at-e-Islami nuk nxitoi politikisht të aktivizohet. Mawlana u përgjigj se lutjet, literatura e botuar bile edhe shkollarët nuk i ndihmuan shumë kësaj çështjeje, dhe kështu do të jetë derisa Islami nuk mishërohet praktikisht me mish e me shpirt me Shtetin Islam. Në këtë kuptim, shpjegoi çështjen se derisa vendet muslimane nuk gjenden nën kontrollin e forcave islame, ato do të jenë në duart e forcave antiislame. Në Botën Islame nacionalizmi nuk mund të ketë kurrfarë lidhjeje me patriotizmin, të shoqëruar me ngjarjet në historinë evropiane. Aq më tepër, ndër muslimanët nacionalizmi gjithmonë nuk është gjë tjetër përpos një vister e mospajtimeve, e kaosit, e anarkisë, e ndarjeve dhe e demoralizimit, të cilat sot janë evidente me rastin e luftës së Botës arabe me imperializmin cionist. Përvetësimi i

²⁰ “Mewdudi slates Bhuto’s Views on Bengalla Desh (Kritikë e ashpër e Mewdudiu kundër pikëpamjeve të Bhutos rreth Bangladeshit) Da’wa, Karaçi, 30 tetor 1972.

nacionalizmit nga ana e vendeve islamike, që të jetë themel i politikës së tyre, do të ishte vetëm një vetëvrasje. Sekularizmi nuk e ka kuptimin e mospërzierjes së shtetit në punët e religjionit, përkundrazi, është mjet i kontrollit të përgjithshëm të shtetit mbi të gjitha aktivitetet fetare, duke e bërë të pamundur efektivitetin e çdo mendimi të pavarur të ulemasë, i cili refuzon të blehet nga ana e pushtetit, që mos të funksionojë në çdo fushë. Në Botën muslimane, sekularizmi do të thotë antireligjion dhe gjendje që është nën mbikëqyrjen e funksionimit të të gjitha elementeve religjioze. Për këtë dëshmon fakti i Turqisë se ç'farë ndodhi në fillim me kemalistët.

Mewdudiu konkludoi kështu: “Pa ndikimin e Xhema’at-e-Islamit në Pakistan, nuk ka kuptim të besojmë se do të bëhet më mirë”.

Çka bëri Mawlana Mewdudiu përkitazi me politikën, si fushë më e rëndësishme e aktivitetit të tij?

“Nga ne kërkohet që në mënyrë të tërësishme t’i dorëzohemi Krijuesit tonë, të ruhemi nga hipokrizia, krahas me luftë ta mbrojmë jetën tonë nga kundërthëniet dhe të bëhemi muslimanë të vërtetë, e për këtë, kërkohet të bëhet një revolucion në rrafshin shoqëror këtu ku ne jemi duke jetuar. Sistemi i tanishëm përqëndrohet në pafesi dhe ateizëm, në lutje zotërave të rrejshëm, në mëkate dhe amoralitet. Dhe, mendimtarët të cilët e shpikën këtë sistem, dhe populli që vrapon pas një burrështeti të këtij sistemi, do të thotë se ky popull e ka lëshuar rrugën e All-llahut, duke dalur jashtë ligjit të Tij. Sa më gjatë që të mbetet udhëheqja në duart e tyre, sa më gjatë që të sundojnë, të kontrollojnë dhe të udhëheqin edhe në fushën e shkencës, diturisë, letërsisë, artit, edukimit, informatave në përgjithësi, në krijimin e ligjeve dhe zbatimin e ligjeve me forcë, në financa, industri, tregti, administratë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, do të jetë shumë vështirë të jetohet si musliman në këtë botë, dhe gjeneratave të ardhshme t’u mbetet një

minimum i besimit islamik. Sa më gjatë që njerëzit e pamoralshëm, rebelët kundër All-llahut, nxënësit e satanës të mbesin në postet e udhëheqësve të botës, aq më tepër nuk ekzistojnë shanset t'i vijë fundi këtij terrori, amoraliteti dhe udhëheqjes së çoroditur. Kjo do të ishte në kundërshtim me mendjen e shëndoshë dhe me natyrën. Pra, që të jemi muslimanë, prej nesh kërkohet ta rrëzojmë këtë udhëheqje kryeneqe dhe rrugën e shtrembët të saj, ta flakim dominimin e pafesisë dhe lutjet zotërave të rrejshëm, për t'i zëvendësuar këta me një besim të vërtetë”.

“Qëllimi i Xhihadit Islamik përqëndrohet në aksionin që t'u vihet fund pushteteve me dominim të sistemeve joislamike, dhe zëvendësimin e tyre me sundimin islamik. Islami kërkon përhapjen e këtij revolucionin në tërë rruzullin tokësor e jo vetëm në një vend ose në disa vende. Për çdo anëtar të Lëvizjes Islamike duhet të jetë si detyrë aktivizimi në revolucion kudo që ai jeton, për arsye se qëllimi i fundit është zhvillimi i revolucionit botëror. Çdo ideologji revolucionare e cila përkrah të mirën e gjithë njerëzisë, e jo vetëm bashkimin kombëtar, ajo nuk mund t'i kufizojë horizontet e veta vetëm në një vend ose në një komb. Për arsye se kjo ideologji është natyrore, duhet ta ketë për ideal që ta zhvillojë revolucionin botëror. E vërteta dhe e drejta që qëndrojnë në këtë anë të malit ose të lumit, njëkohësisht janë të drejta edhe në anën tejtër. Prandaj, asnjë pjesë e njerëzimit nuk mund të ndahet nga këto procese.”²¹

Ndër muslimanët e dobët dëshpërimet dhe frustrimet janë fakt i gjallë, sikurse në botën aktuale, ku materializmi dhe stili perëndimor i jetës parapëlqehen hiç pa dyshim, kështu që çdokund

²¹ Come let us Change This World (Ejani ta ndërrojmë këtë botë), S. Ala Mewdudi, e përshtatur dhe përkthyer nga Kaukab Siddik, Partia Islame për Amerikën Veriore, Uashington, D. C. 1972, faqe 142, 143.

Islami për ta gjendet në një shkallë regresive dhe në rënie, dhe në këso rrethana rezultatet e përpjekjeve kuptohet se janë të dobëta, sidomos tek ata të cilët përpiqen të aktivizohen për një rilindje islamike. Në kohën kur u shtrua ky problem, Mawlana Mevdudiu përgatitej për të shkuar në Londër për një trajtim mjekësor, por megjithatë ai kështu tha:

“Në qoftë se frustrimi dhe zhgënjimi i kanë kapluar edhe veprimtarët islamikë, kjo është rrjedhojë e pritjes së çastit kur përpjekjet e tyre do të sjellin frute para syve të tyre. Ne besojmë se kjo situatë do të ndryshojë, por muslimani duhet të jetë i motivuar vetëm nga një faktor-ta kërkojë kënaqësinë e All-llahut. Sytë tanë janë të përqëndruar vetëm në shpërblimin që duhet të pasojë në atë botë.

Njeriu rezultatet i korrë në këtë botë vetëm në raportet e prodhimeve. Qëllimi objektiv yni përqëndrohet vetëm në atë që ta plotësojmë dëshirën e Krijuesit tonë. Ata të cilët llogarisin në korrijen e sukseseve të përpjekjeve të tyre, duhet të mendojnë në shembujt e atyre të cilët dhanë jetën e tyre në luftën e Bedrit dhe të Uhudit. Ata derdhën gjakun e tyre për ta kryer misionin, por a përjetuan t’i shohin frutet e sakrificave të tyre? Ata i kanë përjetuar rezultatet e luftërave të tyre vetëm në Ahiret. Nuk e kanë derdhur gjakun e tyre për Lëvizjen Islamike po mos të ishin të detyruar t’i bëjnë ato sakrifica për gjeneratat e ardhshme, të cilat ndryshe, kurrë nuk do të mund të dëshmonin për këto ndryshime që e kanë transformuar drejtimin e historisë. Dëshmorët e rënë vetë kurrë nuk janë përpjekur t’i shohin këto rezultate. Nuk jetuan për t’i gëzuar frutet e përpjekjeve të tyre. Synimet e tyre në të vërtetë janë përqëndruar vetëm në realizimin e detyrave

që i kanë pasur për t'i kryer. Këto janë pikësynimet, të cilat duhet t'i kenë parasysh veprimtarët islamikë.”²²

Derisa bëhej trajtimi mjekësor në Londër gjatë vjeshtës dhe dimrit të vitit 1968, Mawlana Mewdudiu i dha një intervistë redaktorit të një reviste mujore në gjuhën arabe të Shoqatës Studentore në Britaninë e Madhe “Al-Ghoraba”, i cili me këtë rast është pyetur se çfarë metodash duhet të përdoren për veprimin e Lëvizjes Islamike në pjesët e ndryshme të botës ku si udhëheqës janë armiqtë dhe despotët. Në këtë pyetje Mawlana kështu u përgjigj:

“Besoj se kjo duhet t'i takojë përgjegjësisë së veprimtarëve dhe udhëheqësve të Lëvizjes Islamike në vendet e veçanta, për ta çmuar në mënyrë inteligjente dhe korrekte natyrën dhe tipin e despotizmit nën sundimin e të cilit ata jetojnë, dhe duke e marrë këtë parasysh, vetë duhet t'i zbulojnë mjetet për të luftuar kundër tij, si dhe të kërkojnë mundësitë e reja për t'i shërbyer kauzës islamike. Natyra dhe kufiri i despotizmit në vendet e ndryshme islamike janë aq të ndirlikuara saqë nuk është e mundur të sugjerohet përdorimi i një standardi të procedurës. Por, ajo që unë besoj, konsiston në faktin se është e nevojshme për të gjitha këto raste të bëhet rezistencë ndaj tentimeve të përdorimit të metodave dhe teknikës sekrete të lëvizjeve nëntokësore dhe revolucioneve të përgjakshme. Ata duhet të përgatiten për të punuar në mënyrë të hapët dhe paqësore për kauzën e All-llahut edhe nëse duhet t'u nënshtrohen rreziqeve të mëdha, vuajtjeve, bile edhe burgimeve, deri në dënimet me vdekje, me varje.”

²² Mewdudi: “Answers-Questions” (Përgjigje-Pyetje), The Muslim, Londër, mars 1969, faqe 128.

Ngjashëm me këtë, redaktori i revistës mujore arabe “Al Muslimun” e pat pyetur se a thua me tentimet e mëvonshme për ta thyer Lëvizjen Islamike në disa vende islamike, të frymëzuara nga fuqitë e mëdha, është përhapur një lloj frike në radhët e Xhema’at-e-Islamit, dhe kjo gjë a i ka dëshpëruar anëtarët e saj për të arritur ndonjë mundësi për sukses, por në këtë Mewlana Mewdudiu u përgjigj:

“Ata të cilët me të vërtetë e duan Islamin, vetëdija e të cilëve është në një nivel të lartë për faktin se kjo kauzë është një gjë e vërtetë, e cila ua përforcon besimin në Islam, kurrë nuk mund të frikohen nga situata aktuale, ose të bien në dëshpërim. Kauza e tillë duhet të konsiderohet si një detyrë për të cilën duhet luftuar në mënyrë që Islami të sundojë, dhe për këtë duhet luftuar deri në frymën e fundit, pa marrë parasysh se lufta e tyre në këtë botë a do të ketë sukses ose jo. Bile, edhe nëse përpjekjet e tyre hëpërhë këtu do të pësonin disfatë, këtë nuk duhet ta konsiderojnë si disfatë, për arsye se janë të bindur që sukcesi real i çlirimit do të përjetohej në Ahiret, kështu që këto duhet të jenë synimet e tyre. Nga ky këndvështrim, sinqerisht po them se kjo nuk është detyrë e vetme e Muxhahedinëve të rënë; disfatë aktuale dhe degradim do të thotë ajo situatë kur populli e pranon se është musliman, por nuk bën asgjë për t’i luftuar dhe përmbysur ata të cilët e pengojnë përhapjen e rendit islamik. Ata e meritojnë dënimin e All-llahut, në të dy botët. Dënimi mund të shtyhet, por kur arrin hidhërimi i All-llahut, mallkimi i Tij do ta kaplojë tërë botën. Megjithatë, sigurse që jam i sigurt se nesër në mëngjes do të lind dielli, insha-All-llah, ashtu edhe forcat islamike do të ngadhënjejnë”.²³

²³ M. Mewdudi: Answers-Questions”, The Criterion, Karaçi, janar-shkurt, 1969, faqe 30-31.

Gjatë karrierës së tij, Mawlana Mewdudiu kritikonte fare pa u trembur punët e mbrapshta të atyre forcave në pushtet, pa marrë parasysh mirëqenien dhe sigurinë e vet. Edhe pse janë bërë disa herë tentime për ta likuiduar, ai asnjëherë nuk e pa të arsyeshme të ndërmarrë ndonjë masë të veçantë për sigurimin e vet ose të ketë ndonjë trup roje. Gjatë fushatës paraelektorale, në dimër të vitit 1970, për angazhimin e tij, ulemaja oportuniste dhe ambicioze ndërmori një tiradë të tërë propagandistike kundër tij në xhamia gjatë hytbeve të xhumave, duke e ofenduar jo vetëm personalitetin e tij, por edhe të gruas, të djemve dhe të vajzave të tij. Tentimin më dramatik që u bë për ta vrarë Mawlana Mewdudiu, gazeta “Pakistan Times” më 8. 7. 1970, e përshkruan kështu:

“Një djalosh i ri nga Xhevherabadi, Zahid Ikbali, të dielën në mbrëmje u dorëzua vetë para aktivistëve të Xhema’at-e-Islamit, pasi që e ndryshoi mendimin për ta vrarë Mawlana Mewdudiu në shtabin e Xhema’a-tit në Lahore. Zahid Ikbali i moshës 14 vjeçare, në konferencën për shtyp tha se është pënduar që planifikoi atentatin mbi Mawlana Mewdudiu kur e pat përcjellë fjalimin e Mewlanas Dhia-Ul-Kasim nga grupi Hezarvi i Xhemi-at-ul-Ulemasë në tubimin publik në Xhevherabad, në ditët e para të gushtit, sipas të cilit Mawlana në fjalë pat deklaruar se Mewdudiu e ka fyer Pejgamberin e Shenjtë dhe se ai beson vetëm në Kur’an. Djaloshi i përmendur, nxënës i klasës VII, deklaroi se sipas ASAR lutësve, ai u “impresionua nga mënyra dhe rruga që ndjek Mawlana Mewdudiu kur u drejtohet aktivistëve të partisë së tij, kur përgjigjet në pyetjet se ai kurrë nuk do ta shpërdorte besimin, të përdorë gjuhë të ndytë ndaj kundërshtarëve, pa marrë parasysh metodat të cilat ata po i përdorin kundër tij.” Shtoi se ishte thellë i impesionuar me fytyrën “Nurani” të Mewlanas, dhe me vërejtjen e tij se pianecët në Pakistan nuk mund ta përhapin Islamin.”

I pyetur për këtë rast se a u regjistrua në polici, Mawlana Mewdudiu deklaroi se vetë personalisht është kundër raportimit të këtij rasti, duke thënë se “Zahid Ikbali nuk ka bërë tentim, por u rrëfye për gabimin e bërë, të cilin unë ia fala.” Megjithatë, disa anëtarë të Xhema’atit ishin të mendimit se ky rast duhet të paraqitet për arsye se ky djalosh kishte si armë një thikë të gjatë 18 inçësh, të cilën deshi ta përdorë kundër kryetarit të Xhema’atit. Zahid Ikbali deklaroi se thikën e kishte vjedhur në një dyqan të farkëtarit në Xhevherabad.

Kur u brengosa për rrezikimin e jetës që i kanoset Mewdudiu dhe për sigurimin e tij personal gjatë fushatës elektorale më 1970, ai në mënyrë të qetë e dha këtë përgjigje: “Besoj se secili që ka besim në All-llahun e Gjithëfuqishëm njëherit gëzon edhe mbrojtjen dhe bekimin e Tij”.

Mawlana Mewdudiu i pat kaluar paraardhësit e tij në luftën për përtëritjen islame ngase ato ishin më cilësore dhe sasiore. Ai, jo vetëm që kishte arritur shkallën më të lartë dhe complete të mjeshtërisë së mësimave islamike, por gjithashtu u bë njohës mendjemprehtë i diturive moderne sekulare. Edhe pse ishte autodidakt, ai posedonte një dituri enciklopedike. Fliste dhe shkruante me lehtësi të njëjtë për religjionin dhe filozofinë, për artin dhe shkencat politike e ekonomike. Gjatë karrierës së tij 40 vjeçare përdori diturinë e akumuluar në mënyrë efektive, për t’i mënjanuar dyshimet e kundërshtarëve që i kishin rreth superioritetit të rendit islamik ndaj të gjitha bindjeve të tjera të jetës. Jo vetëm që shkalla e diturisë së tij qe e mundur të portretohet me përpikëri, por ai ishte në gjendje ta shpjegojë Islamin në detaje, në raport me ideologjitë moderne materialiste, të cilat figurojnë në 100 vepra dhe artikuj që ishin fuqi e madhe tërheqëse dhe ishin simpatike për të rinjtë modernë të shkolluar, por, gjithashtu edhe praktika e jetës së tij private dhe publike, të cilën ia ka treguar botës, ishte në përputhje me jetën e tij të përditshme dhe me predikimet që i bënte. Sikur të gjithë shërbyesit e denjë të Kauzës Islame në të kaluarën, por edhe ata aktuale, edhe ky

ishite njeri i përkryer në tërësi, jovetjak, i patrembur dhe me karakter të një morali të pamposhtur. Gjithmonë i thjeshtë, modest dhe shpirtmirë, ai neveritej nga lajkat që ia bënin, duke evituar edhe pompozitetin, pasurinë dhe jetën luksoze, duke insistuar në thjeshtësinë që duhet kultivuar në shtëpi, për të dhe familjen e tij. Mawlana Mewdudiu nuk ishte vetëm një musliman i përkryer, por ai gjithashtu ushtroi ndikimin për thjeshtësi edhe tek gruaja e tij, të gjashtë djemtë dhe tri vajzat, me tendencë që ata të kenë të njëjtin drejtim sikurse ai që e kishte. Shumë vjet gruaja e tij në Pakistanin Perëndimor ishte udhëheqëse e Degës së Femrave të Xhema'at-e-Islamit. Ajo nuk ishte vetëm shtëpiake dhe nënë e shkëlqyeshme, por kohë të madhe kalonte duke e studiuar Kur'anin dhe Hadithin, dhe shpeshherë u jepte mësim grupeve të femrave të të gjitha moshave të cilat mblidheshin në shtëpinë e saj. Djali më i madh Umar Faruk, në përgjithësi ndihmonte në përgatitjen dhe publikimin e “TERXHUMAN-ul-KUR'ANIT” e po ashtu edhe në shërbimet tjera e ndihmonte babain e vet. Të gjithë fëmijët e tjerë ishin të devotshëm ndaj prindërve, i përkrahnin përpjekjet e tyre, e përcillnin besimin e tyre si persona inteligjentë dhe të edukuar në frymën Islame, por edhe në doktrinat moderne. Çdo pasdite, Mawlana Mewdudiu i paraqitej publikut i ulur së bashku me njerëz të të gjitha moshave dhe strukturave të ndryshme shoqërore në formë rrethi në livadhin para shtëpisë së tij, dhe me ta diskutonte për çdo gjë që kishte të bëjë me Islamin, kurse në marrëdhëniet kombëtare dhe ndërkombëtare ushtronte ndikim të madh. Gjithashtu, Mawlana Mewdudiu shpenzonte një kohë të konsiderueshme në përgjigjet e letrave që i vinin nga çdo vend i botës islame dhe joislame, ose prej njerëzve të ndryshëm të cilët dëshironin të mësojnë diç më shumë për Islamin.

Shumë pak njerëz në kohën e kaluar ose atë aktuale të Rilindjes Islame e kanë kombinuar shkrimin, predikimin dhe veprimtarinë praktike në shkallë aq impresive siç e bëri këtë Mewlana Mewdudiu.

Ai që është muxheddid nuk është peygamber, por me shpirt është shumë afër peygamberisë. Ai karakterizohet me logjikë të pastër, me vizione depërtuese, me mendime të pashtrembëruara, me aftësi të veçantë për ta parë dhe përceptuar rrugën e drejtë, i pastër nga të gjitha ekstremet duke mbajtur një baraspeshë, fuqinë e të menduarit të pavarur, në raport me kohën bashkëkohore, dhe nga paragjykimet e ndryshme të vjetra shekullore shoqërore, duke pasur një kompetencë të veçantë që me kohë ta ndërmarrë Ixhtihadin dhe veprimtarinë e përtëritjes së tij. Pos këtyre cilësive, ai duhet ta ketë pasur dhe kuptuar në tërësi nocionin për Islamin, si një musliman i përkryer në mendime dhe vepra, duke disponuar aftësi ta dallojë Islamin prej joislamit në detaje të rafinuara, dhe aftësi që ta nxjerr të vërtetën nga kaosi dhe shtrembërimet e shtresuara për një kohë të gjatë. Vetëm peygamberët janë krijesa me cilësi më të larta. Fakti themelor me të cilin dallohet Muxheddidi prej Peygamberit, është shkalla e lartë e vetëdijes së plotë të përqëndruar të Peygamberit në kohën kur ai e pranonte Revelatën. Ai pastaj, fillon veprën e misionit të tij me pretendim të Lajmëtarit për t'i thirrur njerëzit që ta ndjekin, kurse pranimi ose refuzimi i thirrjeve të tij që ia bën popullit, përcakton shkallën e njerëzve besimtarë ose jobesimtarë. Përkundër kësaj, Muxheddidi nuk i përkrah këto pozicione, ai nuk është emëruar nga askush, dhe shpesh nuk është i vetëdijshëm se është muxheddid, mirëpo populli atë e cilëson si muxheddid pas vdekjes së tij, bashkë me cilësinë e kontributit që ka dhënë. Zakonisht, ai fillon punën pa asnjë pretendim se është i ngarkuar të kryej një punë të tillë, ndaj nuk e ka për detyrë që populli t'i besojë se është

shpëtues për të mbetur njerëzit muslimanë. Aspektet e ndryshme të përtëritjes islame që duhet t'i ketë parasysh një muxheddid, për afërsisht janë këto:

1. Diagnostifikimi i sëmundjeve aktuale: Të ekzaminohen të gjitha rrethanat dhe kushtet e kohës, dhe të përcaktohet në mënyrë të drejtë se ku, qysh dhe në ç'drejtim shtrihet “injanca” që zhvillohet, ç'farë janë rrënjët e saj dhe cilat janë pozitat e Islamit në këtë periudhë.
2. Skema e reformimit: Të përcaktohet në mënyrë minucioze se ku duhet të ndërpritet kjo shtrirje e së keqes, si dhe të gjendet mënyra të shkatërrohet fuqia joislame, të forcohet Islami në shkallë që ta kaplojë tërë jetën.
3. Vlerësimi i kufizimit të subjekteve njerëzore dhe i resurseve; të peshohet dhe të vlerësohet fuqia subjektive e cila do të jetë në dispozicion, dhe të përcaktohet drejtimi i aksionit për realizimin e reformave.
4. Revolucioni intelektual: Formësimi ideor, besimi dhe morali, pikëpamjet e popullit për modelin islamik, reforma, sistemi i shkollimit dhe përtëritja e shkencave islame, dhe në përgjithësi, qëndrimi ndaj këtyre.
5. Reformat praktike: Çrrënjësja e sjelljeve të këqija, pastrimi i moralit, përtëritja e shpirtit të praktikës së Sheriatit dhe përgatitja e njerëzve për ta udhëhequr Islamin.
6. Ixhtihadi: Të kuptohen parimet themelore të religjionit, të gjykuarit mbi kulturën bashkëkohore, zhvillimi i saj nga pikëpamja islame dhe përcaktimi i efekteve të ndryshimeve brenda modeleve ekzistuese të jetës shoqërore nën Sheriat, me pikëpamje në qëndrim për

përfundimin e tyre dhe aftësimi i Islamit për ta marrë mbi vete rolin e prijësit në rendin e reformuar shoqëror.

7. Mbrojtja e Islamit: Të sulmohen ato forca politike të cilat tentojnë ta përmbysin dhe shkatërrojnë Islamin, të asgjësohet fuqia e tyre në mënyrë që Islami të bëhet një fuqi e gjallë.

8. Përtëritja e sistemit islam: Të rrëmbehet pushteti nga duart joislame, praktikisht të rivëhet pushteti i bazuar në sistemin që është i përshkruar si HALIFAT, sipas modelit të Hazreti Muhammedit.

9. Revolucioni botëror: Nuk duhet të mbetemi të kënaqur me themelimin e rendit islamik në një ose disa vende të banuara me muslimanë, por të fillohet me një lëvizje botërore të fortë, e cila do të jetë e aftë ta përhapë mesazhin revolucionar të Islamit në suaza të tërë njerëzimit në botë; të aftësohet Islami që të bëhet forcë predominante kulturore e botës, të bëhet prijës moral dhe intelektual i njerëzisë. Në rast kur dikush dallohet me aftësi që të bëjë një vepër madhështore në këtë kuptim, ai mund të konsiderohet si muxheddid, por muxheddid ideal (ose Imami Mehdi) mund të jetë vetëm ai person i cili me sukses i realizon të gjitha objektivat që janë të detajizuara më lartë, me të cilat mund të karakterizohet si një trashëgimtar i vërtetë i pejgamberisë.²⁴

Ky nuk është mendimi im, por fakt i gjallë se Mewlana Mewdudiu arriti ta realizojë këtë shkallë në gjashtë pika të këtij programi, duke bërë përpjekje t'i realizojë edhe pikat tjera. Edhe pse ishte njeri i përkryer dhe besimtar i devotshëm, ai fare dhe kurrë nuk ia pat vënë veshin autoritetit të vet personal. Njëherë, me një rast, pat deklaruar se duhej të jetë i lumtur sikur t'i shërbente një

²⁴ Mewlana Mewdudiu me besimin e tij e arriti këtë shkallë, (Muxheddid, arabisht-Reformator).

shteti të vërtetë islamik dhe t'i tregojë aftësitë e tij, por, në asnjë mënyrë nuk do të pranonte ndonjë pozitë me rëndësi nën një regjim nacionalist sekularist. Shumë herët Mawlana Mewdudiu është marrë me studimet e lëvizjeve islamike, duke i njohur rrënjësisht në të gjitha aspektet, duke pasur kujdes jo vetëm për dobësitë e tyre por edhe për aftësitë e tyre, kështu që ai kishte aftësi të përfitojë nga dobësitë edhe sukseset e tyre.

Për një njeri pa një arsimim formal që ka qenë, shkalla e diturisë dhe e të kuptuarit e Mawlana Mewdudiu, ishte ajo që na mahnitte. Me të mund të bisedohej në rrafshin e të gjitha aspekteve, jo vetëm nga lëmi i religjionit, por edhe nga lëmi filozofik, politik, ekonomik, për artin dhe shkencën, duke e stimuluar gjithmonë mendimin inteligjent tek bashkëbiseduesit. Gjatë periudhës së tij aktive, tregoi një mundësi të madhe të kombinimit të diturisë së gjerë, falë aftësive të tij për të gjetur gjithmonë një baraspeshë të pakaluar mentale. Kurrë nuk i tregoi emocionet e veta të cilat mund t'ia turbullonin gjykimin e drejtë, sikurse që kurrë nuk e kam parë, as në rrethanat më provokative, të ketë dalur jashtë kontrollit. Mendimet e tij të hapta, shkrimet dhe fjalimet e tij, po ashtu dëshmonin një shkallë të lartë të baraspeshës së tij mendore, të baraspeshës së përsosur ndërmjet realizmit dhe idealizmit, njëkohësisht kurrë superoptimist ose pesimist i dalluar. Ai luftonte në shumë fronte në mënyrë simultane kundër prapambeturisë, si dhe kundër modernizmit, konservativizmit dhe përherë kryefortë kundër risive diskrete.

Shumë rrallë mund të gjenden te një njeri kaq kombinime të dalluara, si në rrafshin e veprimtarive të gjera të shkrimeve të tij, madje, si prijës fetar me urti të një burrështeti. Për dallim nga shumë dijetarë muslimanë, Mawlana Mewdudiu nuk ishte plotësisht i kënaqur me shkrimet dhe predikimet që i kishte bërë, por besonte se e ka për detyrë ta realizojë implementimin praktik të asaj që është predikuar, duke u munduar të vërë bazat për themelimin e një organizate islamike më

të fortë se që ishte, më aktive dhe më të disiplinuar në botën aktuale, në kuadër të XHEMA'AT-e-ISLAMIT. Por, keqësimi i gjendjes shëndetësore dhe mosha e shtyrë, këtë synim ia bënë të pamundur Mawlana Mewdudiu, mu atëherë kur prej tij pritej një angazhim më i madh dhe jetë më aktive. Në fund, arriti të pushojë me një kënaqësi aq të dalluar sa që gjatë këtij shekulli asnjë individ nuk i kontribuoi më shumë Kauzës Islame se vetë Mawlana Mewdudiu.

Mawlana Seyyid Abul Ala Mewdudi (1903-1979), muxheddid i madh bashkëkohor dhe themelues i Indo-Pak. XHEMA'AT-e-ISLAMIT, kishte lidhje të ngushtë me Lëvizjen Islamike në tërë botën, në luftë për krijimin e një shteti të vërtetë islamik kundër kolonializmit, imperializmit dhe kundër të gjitha ideologjive anti-islamike. Edhe pse nuk kreu asnjë shkollë fetare, ai pa ndihmën e kurrkujt krijoi një literaturë islamike më të pasur në periudhën moderne, e cila u përkthye në shumë gjuhë të njohura, duke e inspiruar Lëvizjen Islamike në shumë vende, në Lindje dhe në Perëndim, nën emra të ndryshëm.